TRANSPARENCY INTERNATIONAL
MACEDONIA

KORRUPSIONI I LARTË DHE HARTIMI I LIGJEVE SIPAS NEVOJËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

TRANSPARENCY INTERNATIONAL
MACEDONIA

KORRUPSIONI I LARTË DHE HARTIMI I LIGJEVE SIPAS NEVOJËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

PROJEKTI:
Ndalimi i pandëshkueshmërisëpër korrupsionin e lartë në Ballkanin perëndimor dhe Turqi

* ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian

Ky raport është përgatitur nga Transparency International – (Transperënsi Interneshënëll) Maqedoni në bashkëpunim me Sekretariatin e Transparency International në Berlin.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Transparency International – Maqedoni dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Për Transparency International Maqedoni,

Slagjana Taseva, PhD, Presidente

Metodi Zajkov, Sekretar i përgjithshëm

* Transparency International – Maqedoni është përgjegjës për përmbajtjen e këtij dokumenti dhe në asnjë rethanë nuk duhet të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Europian.

Ky dokument është përgatitur si pjesë e projektit “Dhënia fund për korrupsionin e lartë në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi”, të mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian.

Autore: **Slagjana Taseva** Ph.D

Bashkëpuntorë: **Adrijana Rushiti** dhe **Soraja Jusufoska**

Shtypi: Datapons Skopje

Tirazhi: 100 kopje

Kopertina: Stamat Naumovski

Janë bërë përpjekje maksimale për verfikimin dhe saktësinë e të dhënave që përmban ky raport. Besohet se i gjithë informacioni që nga nëntori i vitit 2020 është i saktë. Në asnjë rast, Transparency International- Maqedoni nuk mban përgjegjësi për pasojat nga përdorimi i këtij raporti për qëllime tjera dhe për kontekst tjetër.

ISBN: 978-608-66251-6-0

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE 5
HYRJA 9
THEMELIMI I PROKURORISË SPECIALE PUBLIKE 11
REFORMAT NË GJYQËSOR 12
KONTEKSTI 15
METODOLOGJIA 16
GJETJET DHE DISKUTIM 19
KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË RASTEVE TË ANALIZUARA 19
KAPJA E SHTETIT NË RASTET E ANALIZUARA 23
PUNA E PROKURORËVE 27
AKTGJYKIMET 27
LIGJET E HARTUARA SIPAS NEVOJËS 29
LLOJET DHE PROCESI I MIRATIMIT TË LIGJEVE TË HARTUARA SIPAS NEVOJËS 30
REAGIMET NDAJ LIGJEVE TË HARTUARA SIPAS NEVOJËS 32
LIDHJA ME RASTET KORRUPTUESE 33
PËRFUNDIMI 35
REKOMANDIMET 37

PSP- PROKORORIA SPECIALE PUBLIKE

RMV – REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

PP- PROKURORIA PUBLIKE

PTHPKOK – PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE PËR NDJEKJEN E KRIMIT E ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

KSHPK- KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

MPB – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

PSP – PROKURORI SPECIAL PUBLIK

PP –PROKURORI PUBLIK

KP – KODI PENAL

LPP – LIGJI PËR PROCEDURËN PENALE

LKGJ – LIGJI PËR KËSHILLIN GJYQËSORË

LGJ – LIGJI PËR GJYKATAT

LPP – LIGJI PËR PROKURORINË PUBLIKE

BE – BASHKIMI EUROPIAN

KE –KOMISIONI EUROPIAN

GRECO – GRUPI I SHTETEVE TË EUROPËS KUNDËR KORRUPSIONIT (GREKO)

UNCAC – KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KORRUPSIONIT (SHQIP: KKBKK)

ACCMIS – SISTEMI I AUTOMATIZUAR INFORMATIV PËR MENAXHIM ME LËNDËT GJYQËSORE (SHQIP: SIAMLGJ)

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky raport është pjesë e projektit të financuar nga BE Dhënia fund e korrupsionit e pandëshkueshmërisë për korrupsionin e lartë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Bashkarisht me kolegët nga kapitujt nacional të Transparency International në rajon, ne synojmë që të informojmë diskutimin për kapjen e shtetit, nivelin e lartë të korrupsionit, dhe ligjet e përshtatura sipas nevojës në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedonia e Veriut, Serbi dhe Tuqi.

Analiza jonë ka gjetur shumë raste që përmbushin përkufizimin e Transparency International për korrupsionin e lartë dhe ekzistimin e konfirmuar të strukturave të organizuara kriminale që përfitojnë nga keqpërdorimi i pushtetit. Studimi paraqet dëshminë për sundim joefektiv të ligjit për shkak të kapjes të shtetit në gjyqësor dhe instituticone tjera dhe legjislacionin e hartuar sipas nevojës. Si rezultat, veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar, siç janë keqpërdorimi i pozitës zyrtare, larja e parave, dhe puna e paskrupullt në shërbim kanë kaluar pa ndëshkuar nga mjetet efektive ligjore. Dëmi i përgjithshëm për buxhetin e shtetit dhe individët për 30 rastet e analizuara është përafërsisht 255.2 milion euro duke u bazuar në akuzat nga Prokuroria Speciale Publike (PSP) dhe dokumentet tjera relevante. Vlera e përgjithshme e pronës të ngrirë apo të konfiskuar në këto raste është reth 38 milion euro.

Problemet me sundimin e ligjit janë dokumentuar për herë të parë në vitin 2015 në të ashtëquajturin Raport i Pribesë[1] dhe kjo është bërë edhe më e qartë pas rrjedhjes të bisedave të përgjuara në të cilat zyrtarët e lartë qeveritarë manipulojnë votat, blejnë gjykatës dhe ndëshkojnë kundërshtarët politik.[2] PSP-ja[3] është themeluar për të hetuar zyrtarët e korruptuar dhe që të rikthejë besimin në ligj dhe në sistemin gjyqësorë. Por PSP-ja nuk ka ruajtur integritetin e saj, ashtuqë prokurores themlore të saj i është shqiptuar dënim me burg prej shtatë vitesh për keqpërdorim të pozitës të saj zyrtare në një rast që lidhej me punët e zyrës të saj.[4] PSP-ja është shpërbërë, dhe rastet e saj janë kthyer në Prokurorinë Publike (PP) jofunksionale. PSP-ja ka lënë pas 19 hetime kundër më shumë se 150 zyrtarëve të akuzuar[5], shumica e të cilëve ishin akuzuar me shkelje të shumta.[6]Ato raste tani po vazhdojnë

[1] Rekomandimet e KE kanë themeluar Grupin e lartë të ekspertëve për Sundimin e ligjit të publikuar në të ashtëquajurin "Raport i Pribesë të publikuar në vitin 2015."

[2] Liderët maqedonas të paaftë për të zgjidhur krizën www.nytimes.com/2015/05/19/world/europe/macedonias-leaders-unable-to-resolve-festering-crisis.html?_r=0

[3] "Prokuroria Publike për ndjekjen e veprave penale që lidhen dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes jo të autorizuar të komunikimeve"

[4] https://360stepeni.mk/presuda-za-reket-9-godini-zatvor-za-boki-7-za-janeva/

[5] 19 hetimet e Prokurorisë Speciale Publike të ndërmarra nga prokuria publike e rregulltë janë: Rrezet X; Prodhuesi; Transportuesi 2; Tarifa 2; Shërbimet e huaja; Drumarina; Liderët; Aktor; Regjistrimi; I fuqishmi; Perandoria; Banka Postare; Dizajni; Propaganda; Harmonia; Stacioni i bazës; Pacienti; Dhurata; Bordi. Ndërmjet të dyshuarve në këto raste është edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, dhe kryetari i mëparshëm i VMRO-DPMNE (OBRM PDUKM), Nikola Gruevski (hetimi "Lideri" dhe "Regjistrimi"), Zëvendës Kryeministri Bujar Osmani (hetimi "Pacienti"), deputeti i VMRO-DPMNE Antonio Miloshoski (hetimi "I fuqishmi"), Ministri i mëparshëm i financave Zoran Stavrevski (hetimi "Dhurata"). Megjithatë, ndërmjet 19 hetimeve janë edhe rastet "Perandoria" dhe "Banka Postare", që në bazë të disa të dyshuarve janë përdorur për kërcënim kundër tyre, që ka rezultuar në rastin "Zhvatja".

[6] Po aty

në gjykata. Megjithatë, shumë pak raste të korrupsionit të lartë kanë rezultuar në aktgjykime të sukseshme. Në disa që kanë patur sukses, zyrtarëve të lartë u është shqiptuar vetëm dënim minimal nga gjykatat.

Analiza jonë tregon një shkallë të lartë të pandëshkueshmërisë për korrupsionin e lartë në Maqedoninë e Veriut. Institucionet dështuan që të hetojnë korrupsionin e lartë kur ata e kanë ndjerë se një rast mund të shpie në qarqe të larta të qeverisë. Niveli i lartë i korrupsionit nuk është ndjekur edhe pas ndryshimit të qeverisë. Presidenti aktual, Stevo Pendarovski, ka theksuar në një intervistë[7] në 15 tetor të vitit 2020, se asnjë politikan i lartë nuk është nxjerrë para drejtësisë dhe të mbahet përgjegjës për korrupsion. Ata duket sikur të gjithë gëzojnë imunitet për shkak të kulturës të mbrojtjes politike dhe kontrollit të partisë.[8] *Raporti nacional i sistemit të integritetit të* TI Maqedoni nga maji i vitit 2016 ka gjetur se "mangësitë në pavarësinë e legjislacionit dhegjyqësorit, dhe dështimi i tyre për të mbikqyrur ekzekutivin, theksojnë mangësi kritike në sistemin e mekanizmave kontrollues." Në analizën tonë, procedurat gjyqësore në çdo rast gjyqësorë janë shtyrë, duke zgjatur mesatarisht pesë vjet. Dy procedura gjyqësore kundër dy ish kryeministrave janë vjetërsuar pasi kaloi koha e parashkrimit. Njëri prej ish kryeministrave ka shmangur dënimin me burg prej dy vjetësh në një rast tjetër duke u larguar në Hungari, ku ka fituar azil politik. Fakti që askush nuk është mbajtur përgjegjës për largimin e tij me automjet përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi është një tregues tjetër i shtetit të kapur.

Detajet për shumicën e rasteve të analizuara ishin të disponueshme në faqen e internetit të PSP-së si dhe në raportet e mediave. Megjithatë, informacioni nuk është më i dispoueshëm pas shpërbërjes të PSP-së. Kodi Penal (KP) i Maqedonisë së Veriut nuk ka përkufizim për korrupsionin e lartë. Shumica e rasteve të analizuara përmbajnë akuza për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar, larjes të parave dhe të ardhurave të përfitutuara në mënyrë të kundërligjshme, dhe pranimin e dhuratës për ndikimin e kundërligjshëm. Aktakuzat gjithashtu kanë përfshirë akuza për krijimin e organizatës kriminale për mashtrim, dhënie dhe marrje të rryshfetit, përvetësim të kundërligjshëm, ndimë për kryerësin e veprës penale, falsifikim të dokumenteve zyrtare, dëmtim apo privilegjim të kreditorëve, dhe punë e papërgjegjshme në shërbim.

Miratimi i ligjeve të përshtatura sipas nevojës për të përfituar grupet e interesit privat është gjithashtu një problem serioz në Maqedoninë e Veriut. Ne kemi zgjedhur 12 ligje për të ilustruar këtë praktikë të shpeshtë dhe shqetësuese. Ligjet e hartuara sipas nevojës janë përdorur në rastet specifike të korrupsionit të lartë dhe janë dëshmi e fuqishme të kapjes të shtetit.

Ne rekomandojmë se Maqedonia e Veriut duhet të të ndërmarrë hapa konkret për të përforcuar sundimin e ligjit. Rekomandimet tona përfshijnë:

- Këshilli Gjyqësorë dhe Këshilli i Prokurorëve duhet të miratojnë masa më të rrepta për integritetin e gjykatësve dhe prokurorëve.
- Komisioni Europian duhet të kryejë vlerësime shtesë të udhëhequra nga ekspertët ngjajshëm me Raportin e Pribesë.
- Institucionet duhet të hulumtojnë dhe të hartojnë strategji më të mira për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë.
- Duhet të themelohet një grup pune për reformën e gjyqësorit dhe për të realizuar një vlerësim gjithëpërfshirës të shkaqeve themelore të kapjes të shtetit në gjyqësor,

[7] TV Telma, Intervistë me Stevo Pendarovskin, Presidenti i Republiksë të Maqedonisë së Veriut, 15 tetor 2020

[8] Po aty

prokurorinë publike, dhe policinë, dhe të propozojë zgjidhje të bazuara në dëshmi.

- Qeveria duhet të përfshijë ekspertët nacional dhe shoqërinë civile në krijimin e politikave dhe mbikqyrjen e gjyqësorit, prokurorisë publike dhe policisë.
- Ndikimi politik duhet të largohet në mënyrë efektive nga emërimi, vlerësimi, avancimi dhe shkarkimi i gjykatësve dhe prokurorëve publik, si dhe anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publik.
- Kuvendi i Maqedonisë së Veriut duhet të vendos kritere të qarta dhe procedura transparente për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësorë që nuk janë gjykatës.
- Gjykatat duhet të japin shpjegim të detajuar të vendimeve të tyre të paraburgimit.
- Kuvendi duhet të sigurojë mbikëqyrje kundër-korrupsionit të legjislacionit para se ligjet të parashtrohen në parlament.
- Qeveria duhet të përfshijë ekspertët nacional dhe palët e përfshira relevante në grupet punuese për të hartuar ligje dhe amendamente ligjore.
- Qeveria duhet të hartojë ligj të ri për lobimin për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në kontaktet ndërmjet zyrtarëve dhe lobistëve dhe të jap një prezantim të qartë të interesave në aktivitetet ligjvënëse.
- Qeveria duhet të zbatojë Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të edukojë qytetarët për mundësinë e raportimit të korrupsionit në mbrojtjen e interesit publik.

HYRJE

"Korrupsioni i lartë" është bërë një fazë e zakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por nocioni rrallëherë përkufizohet në mënyrë që i bën të qartë reformat e nevojshme gjyqësore dhe legjislative. Organizatatat ndërkombëtare si Grupi i Shteteve të Europës kundër Korrupsionit (GREKO) dhe Komisioni Europian (KE) kanë thënë se Maqedonia e Veriut ka miratuar legjislacionin kundër korrupsionit për të përmbushur standardet ndërkombëtare. Megjithatë, vendi nuk ka vazhduar me zbatimin, duke shkatërruar besimin publik në sundimin e ligjit. Politikanët e fuqishëm në Maqedoninë e Veriut gëzojnë pandëshkueshmëri, ligje të hartuara sipas nevojës për të përfituar interesi privat, dhe ndërhyrje në sistemin e gjyqësorit. Ky raport synon që të qartësojë natyrën dhe shkallën e korrupsionit të lartë në Maqedoninë e Veriut përmes identifikimit të rasteve të kapjes të shtetit në sistemin e gjyqësorit dhe ligjet e hartuara sipas nevojës.

Karakteristikat e përbashkëta të rasteve të analizuara do i ndihmojnë qytetarëve dhe shoqërisë civile që të njoh kapjen e shtetit dhe të zhvillojë treguesit e qartë për integrim në BE, që vlerësojnë, "hapat e qeverisë për të rikthyer mekanizmat e kontrollit, dhe për të përforcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit."[9]

INFORMACIONE THEMELORE PËR TRANZICIONIN DHE LEGJISLACIONIN ANTI-KORRUPSION NË MAQEDONINË E VERIUT

Republika e Maqedonisë së Veriut ka qënë në tranzicion që nga pavarësia e saj në vitin 1991. Rënia e komunizmit dhe shpërbërja e Jugosllavisë ka ngarkuar sistemin politik dhe ekonomik me lloje të reja të kriminalitetit. Kufijtë e rinj nacional dhe embargot kanë krijuar mundësi për kontrabanduesit, ndërsa privatizimi i kompanive shtetërore dhe resurseve kanë transferuar pasurinë në duart e personave të përfshirë në politikë. Kjo ka shënuar fillimin e kapjes të shtetit në Maqedoninë e Veriut. Ky fenomen është mishëruar tani në shoqëri, për shkak të ekonomisë të dobët dhe mungesës të kontrollave të jashtme. Komuniteti ndërkombëtar ka luajtur një rol të rëndësishëm në lehtësimin e nënshkrimit të së ashtuquajturës Marrëveshje e Ohrit[10] që ka zgjidhur krizën e brendshme të sigurisë në vitin 2001. Ngjajshëm, ndërmjetësimi i Bashkimit Europian ka shpier në Marrëveshjen e Përzhinës[11] në vitin 2015 që ka zgjidhur krizën politike dhe protestat kundër korrupsionit dhe mungesës të besimit në sundimin e ligjit.

Maqedonia ka miratuar Kodin Penal në vitin 1996[12] dhe ka ndryshuar të njëjtin disa herë për të integruar standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në vitin

[9] Raporti i vitit 2019 për Maqedoninë e Veriut, Komunikatë për Politikën e zgjerimit të BE-së

[10] Marrëveshja kornizë (Marrëveshja e Ohrit) e nënshkruar në 13 gusht të vitit 2001. Një marrëveshje kornizë për sigurimin e të ardhmes të demokracisë të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe lejimin e zhvillimit të marrëdhënive më të afërta dhe më të integruara ndërmjet ish Republikës Jugoslave të Maqedonisë dhe komunitetit Euro-Atlantik www.osce.org/files/f/documents/2/8/100622.pdf

[11] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf

[12] Gazeta zyrtare nr 37/96, në fuqi në 1 nëntor i vitit 1996

2002, shteti ka miratuar ligjet e tij e para anti-korrupsion[13] dhe ligjet kundër larjes të parave dhe ka themeluar Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Ligji për procedurën penale i vitit 2010 (LPP) ka futur policinë gjyqësore dhe njësitë hetuese.

Një amendament i Kushtetutës[14] në vitin 2002 ka mundësuar përdorimin e masave speciale hetuese. Si rezultat, Ligji për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale janë miratuar dhe masat për mbrojtjen e dëshmitarëve janë shtuar në LPP. Në vitin 2005, janë ndryshuar 11 nene të Kushtetutës sipas rekomandimeve të Programit shtetëror të vitit 2003 për parandalimin dhe represionin e korrupsionit, kryesisht për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit.[15] Është miratuar Ligj i ri për gjykatat në maj të vitit 2006,[16] si dhe Ligji i ri për Këshillin Gjyqësorë.[17]

Reformat e tyre janë përshëndetur nga vlerësimet e pavarura, siç janë raportet e vlerësimit të GREKO-s dhe Raporti i progresit nga Komisioni Europian. Megjithatë, Raporti i progresit i KE-së ka theksuar se korrupsioni i përhapur gjërësisht mbetet një çështje për shqetësim dhe se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të përditësuar kornizën ligjore.[18]

STANDARDET NDËRKOMBËTARE KUNDËR KORRUPSIONIT SI DREJTUES TË NDRYSHIMIT

Rezultatet e para në përforcimin e kapacitetit të Maqedonisë së Veriut për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe larjen e parave janë arritur me bashkëpunimin aktiv të organizatave ndërkombëtare. Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar traktatet multilaterale duke përfshirë edhe Konventën penale për korrupsion të Këshillit të Europës (ETS 173) në 28 korrik të vitit 1999;[19] Konventa e KB në luftimin e krimit të organizuar ndërkufitar (Konventa e Palermos) dhe Protokollet e saj në vitin 2000; Protokolli shtesë i Konventën penale për korrupsion (ETS 191) në 14 nëntor të vitit 2005;[20] Konventa Europiane për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Konventa e KB-së kundër korrupisonit (UNCAC)[21] në vitin 2007.

Në vitin 2020, GREKO[22] ka shënuar një përparim të konsideruar nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ka mbindërtuar vlerësimin e saj të harmonizimit me rekomandimet e GREKO nga “përgjithësisht të pakënaqshme” në “të kënaqshme”.

Maqedonia e Veriut ka përfunduar raundin e parë dhe të dytë të vlerësimit nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC). Vlerësimet kanë theksuar sukseset e caktuara, siç janë e drejtat e kompensimit të njerëzve që dëshmojnë apo japin deklarata në procedurën e korrupsionit dhe themelimin e agjencisë të veçantë për menaxhimin e pasurisë të ngrirë, dhe të konfiskuar. Vlerësuesit e UNCAC gjithashtu kanë identifikuar disa

[13] Gazeta zyrtare nr 28/02 Ligji është ndryshuar në vitin 2004, 2006 dhe 2008. Ligji i ri për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interest është miratuar në janar të vitit 2019

[14] Neni 17 nga Gazeta Zyrtare nr. 91/2002

[15] Gazeta Zyrtare nr. 107/2005

[16] Gazeta Zyrtare nr.11/05

[17] Gazeta Zyrtare nr.60/05

[18] Raporti i progresit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë së Veriut në vitin 2009 – Komisioni për komunitetet europiane, 14 tetor 2009

[19] Konventa ka hyrë në fuqi në 1 korrik të vitit 2002 dhe Republika e Maqedonisë nuk ka paraqitur ndonjë rezervë

[20] Ajo ka hyrë në fuqi në 1 mars të vitit 2006 dhe Republika e Maqedonisë nuk ka paraqitur ndonjë rezervë në Protokollin shtesë të Konventës të së drejtës penale për korrupsionin.

[21] Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (UNCAC) ka hyrë në fuqi në 14 dhjetor të vitit 2005, Republika e Maqedonisë ka ratifikuar UNCAC në vitin 2007, Gazeta Zyrtare 37/07

[22] Në Seancën plenare të mbajtur në 24 shtator të vitit 2020

sfida në zbatim dhe baza për përmirësim të mëtutjeshëm.[23] Raundi i dytë i vlerësimit ka theksuar nevojën për qartësimin e roleve institucionale të administratave të ndryshme në kthimin e pronës, , duke patur parasysh përplasjen e kompetencave të tyre (Neni 51). Në reagimin e saj, Maqedonia e Veriut ka themeluar Zyrën për kthimin e pasurisë (ARO) në kuadër të Prokurorisë të lartë publike.

AGJENDA ANTI - KORRUPSION NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE

Luftimi i korrupsionit është komponenta kryesore e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim[24] (neni 78) të nënshkruar ndërmjet BE-së dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut në vitin 2004. Shteti është ligjërisht i detyruar të përmbush dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Në raportin e progresit të vitit 2015, Komisioni Europian ka identifikuar si pengesë ndikimin e drejtëpërdrejtë politik mbi gjyqësinë. Raporti i progresit për vitin e ardhshëm ishte më alarmues, duke përfunduar se Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet i kapur me institucione të kapura. Raportet në vitet 2018 dhe 2019 kanë shënuar pak progres në reformat urgjente prioritare, duke përfshirë reformat në gjyqësor.

Në 1 korrik të vitit 2020, KE i ka prezantuar Këshillit projekt kornizat e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, duke vendosur udhëzimet dhe parimet për bisedat e anëtarësimit. Sipas propozimit, kapitujt e anëtarësimit do të grupohen në disa të ashtëquajtur kllasterë; procesi i negociatave mund të rikthehet nëse nuk ka përparim; dhe shtetet kandidate janë të detyruara që të realizojnë reformat.[25] Metodologjia e re kërkon që të ketë një proces politikisht të besueshëm, llogaridhënës dhe transparent dhe i është prezantuar Parlamentit.[26]

Në 24 mars të vitit 2020, liderët europian kanë konfirmuar vendimin për të hapur negociatat për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Pasiqë shtetet anëtare kanë miratuar kornizat e negociatave, kryetari i Këshillit të BE-së do të prezantojë pozitën e BE-së duke shënuar fillimin formal të negociatave për anëtarësim. Korniza e negociatave do të bëhet publike në atë fazë.[27]

THEMELIMI I PROKURORISË SPECIALE PUBLIKE

Parlamenti ka themeluar Prokurorinë Speciale Publike në shtator të vitit 2015 pas një sërë skandalesh që përfshin përgjimin e pretenduar të kundërligjshëm të mijëra aktorëve politik dhe shtetërorë, të cilat, sipas Komisionerit të BE-së Johanes Han, ka zbuluar “shqetësime serioze për ndërhyrjen politike dhe korrupsionin e nivelit të lartë”, dhe kanë futur shtetin në

---

[23] Siç janë: konsideratat për përdorim të gjërë të neneve 253 (rryshfeti pasiv), dhe 253-a (rryshfeti aktiv) i KP, Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të dorëzojë kopje të ligjeve të saj që inkriminojnë larjen e të ardhurave nga veprat penale deri te Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (neni 23, parag 2(d) i Konventës); Në lidhje me pasurimin e paligjshëm, shteti është inkurajuar që të rrisë zbatimin efektiv të nenit 359-a të KP (neni 21 i Konventës) për të zgjeruar fushëveprimin e zbatimit të dispozitave të brendshme në inkriminimin e tentativës për të mbuluar të gjithë veprat korruptuese (neni 27, paragrafi 2 i Konventës), dhe shteti është i inkurajuar që të vazhdojë përpjekjet për të miratuar legjislacionin specifik në mbrojtjen e personave që raportojnë (neni 22 i Konventës).

[24] Vendimi 2004/239/EC

[25] https://www.slobodnaevropa.mk/a/30447124.html

[26] https://www.sobranie.mk/sednici-nsei-16-ns_article-novata-metodologija-za-proshiruvanje-na-evropskata-unija-prezentirana-pred-nacionalniot-sovet-za-evr.nspx

[27] Komisioni Europian, *Komisioni harton kornizën e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut,* Komisioni Europian – Njoftim për shtyp, 1 korrik i vitit 2020

krizë.[28]

Në shkurt të vitit 2015, lideri i opozitës Zoran Zaev ka publikuar një sërë audio materiale – që ai i ka quajtur "bomba" – nga 670,000 biseda të inçizuara në mënyrë të fshehtë të më shumë se 20,000 numrave telefonik. Në inçizimet e publikuara, zyrtarët e lartë qeveritarë janë dëgjuar duke komplotuar për të manipuluar votat, duke blerë gjykatës dhe duke ndëshkuar kundërshtarët politik. Zaev ka thënë se inçizimet janë bërë nga qeveria dhe janë shpalosur nga opozita.[29] Në maj të vitit 2015, tre partitë e mëdha politike kanë nënshkruar Marrëveshjen e Përzhinës.[30] Kjo marrëveshje me ndërmjetësim nga BE ka përfshirë krijimin e PSP-së për të hetuar paligjshmëritë dhe korrupsionin e theksuar në bisedat e përgjuara.

PSP-ja duhej që të punojë në mënyrë të pavarur dhe autonome nga Prokurori Publik (PP) Republikan, me ekipin e saj të juristëve, hetuesve, hulumtuesve dhe ekspertëve të TI-së.[31] Megjithatë, PSP-ja është shfuqizuar në vitin 2019 pasiqë shefi i saj, Prokurori Special Publik (PSP), ka dhënë dorëheqje për rolin e saj në skandalin e madh të korrupsionit me emrin "Zhvatja".

Shefi i mëparshëm i PSP-së ishte sanksionuar me shtatë vite burg për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar.[32] Në 16 shtator të vitit 2019, Këshilli i PP-së ka shfuqizuar mandatet e të gjithë prokurorëve të PSP-së dhe ka rishpërndarë ata në zyrat e prokurorive ku ata kanë punuar më parë.[33] PSP-ja është shfuqizuar, hetimet e saj ishin transferuar në Prokurorinë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit (PTHPKOK).[34] PSP-ja kishte pesë lëndë të zgjidhura, dy të mbyllura me hedhjen poshtë të aktakuzave, 15 lëndë aktive para gjykatave penale, katër lëndë të kthyera në rigjykim, dy lëndë në të cilat pritej vendimi i Gjykatës të Apelit dhe 19 hetime vijuese kundër më shumë 150 funksionarëve të akuzuar[35] për të cilat nuk ishin ngritur aktakuza. Gjithsej, bëhet fjalë për 40 procese të papërfunduara pas katër viteve punë.[36]

REFORMAT NË GJYQËSOR

Pas Marrëveshjes të Përzhinës, qeveria e re ka miratuar Strategjinë për reforma në sektorin e gjyqësorit në vitin 2017. Strategjia përcaktoi udhëzimet për vendosjen e pavarësisë të gjyqësorit në tre faza. Megjithatë, zbatimi i Strategjisë është ende në pritje.

Strategjia ka përfunduar se pavarësia e gjyqësorit është kompromituar nga ndërhyrja politike në zgjedhjen e gjykatësve dhe gjykimin e rasteve ku interesi i qeverisë ishte në rrezik. "Pavarësisht nga të gjithë projekt ligjet dhe institucionet e reja në sektorin juridik, dhe inkorporimin e standardeve dhe normave ndërkombëtare në sistemin ligjor, mbetet problemi i zbatimit jo konsistent," sipas hyrjes të Strategjisë. "Rezultatet e arritura në fushën e efikasitetit gjyqësorë mbeten në hije për shkak të pavarësisë të penguar, që rezultojnë në

[28] Transparency International Maqedoni, *Vlerësimi nacional i integritetit,* (Shkup: TI Maqedoni, 2016). www.transparency.mk/en/images/stories/NIS_eng.pdf

[29] www.nytimes.com/2015/05/19/world/europe/macedonias-leaders-unable-to-resolve-festering-crisis.html?_r=0

[30] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf

[31] Neni 6 nga Ligi për Prokurorinë Publike për ndjekjen e veprave penal që lidhen dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes jot ë autorizuar të komunikimeve

[32] https://360stepeni.mk/presuda-za-reket-9-godini-zatvor-za-boki-7-za-janeva/

[33] https://emagazin.mk/prekinuva-mandatot-na-site-obviniteli-na-s-o-utre-e-se-odluchi-dali-e-se-vratat-vo-matichnite-obvinitelstva/

[34] Article 108 Law for the Public Prosecution, Official Gazette of the RN Macedonia no 42 from 16 February 2020

[35] https://360stepeni.mk/site-istragi-na-sjo-konechno-vo-pogon/?fbclid=IwAR0khhWi9S0xXVvRDD5DEzfkMssP7d5X1_ciIgHwM4pZnZEG3T0O8srObHU

[36] https://prizma.mk/janeva-go-ostava-sjo-so-samo-tri-zavrsheni-sluchai/

cilësi të ulët dhe mosbesim të qytetarëve në institucionet e sistemit gjyqësorë."[37]

Këto përfundime janë në pajtim me gjetjet e TI e Vlerësimit të Sistemit Nacional të Integritetit (SNI) të TI Maqedoni të vitit 2017.[38] Rezultati i përgjithshëm i shtyllës të gjyqësorit ishte 53/100 ndërsa rezultati për llogaridhënie, pavarësi dhe integritet të gjyqësorit ishte 25/100. SNI ka rekomanduar zëvendësimin e emërimeve politike me punësime të bazuara në meritë; hartimin e Kodit të unifikuar të etikës gjyqësore dhe udhëzimet për zbatimin e tij; dhe vendosjen e rregullave për gjykatësit në lidhje me pranimin e dhuratave, mikpritjen dhe përfitimet tjera.

Një studim i publikuar në shtator të viti 2020[39] ka përcaktuar se paraburgimi është përdorur zakonisht për vepra penale më të lehta por pothuajse asnjëherë në rastet e korrupsionit para PSP-së. Autorët kanë theksuar nevojën për të qartësuar dispozitat e paraburgimit dhe të ndërtojnë një sistem për praktika uniforme të gjykatësve dhe prokurorëve publik. Një studim tjetër i fundit ka treguar se 52 përqind e qytetarëve nuk i besojnë gjyqësorit për shkak të korrupsionit dhe ndikimit të jashtëm.[40]

Amendamentet e fundit në Ligjin për Gjykatat[41], Ligjin për Këshillin e Gjyqësorë dhe Kodeksin e sjelljes të gjykatësve[42] kanë përmirësuar situatën. Vlerësimi i fundit nga Komisioni i Venedikut për Ligjin për Gjykatat ishte pozitiv për përparimin në reformat prioritare në procesin e integrimit Europian.[43] Në shkurt të vitit 2020, Maqedonia e Veriut ka miratur Ligjin e ri për Prokurorinë Publike[44] duke i dhënë pavarësi financiare PTHPKOK që ka zëvendësuar PSP-në.

Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publik (LKPP) rregullon përzgjedhjen e prokurorëve publik. Duke u bazuar në rekomandimet e Raportit të Pribesë, gjykatësit dhe prokurorët publik duhet të përzgjidhen nga Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik dhe të avancohen vetëm pas vlerësimit pozitiv. Përjashtimi i vetëm është prokurori publik i Republikës të Maqedonisë së Veriut, që duhet të ketë përvojë të vazhdueshme të punës prej të paktën dhjetë vitesh si prokuror publik apo si gjykatës në fushën e të drejtës penale.[45]

> Raporti i BE-së për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, fq 16:
>
> Sistemi gjyqësor i Maqedonisë së Veriut është i përgatitur në mënyrë të moderuar. Ka përparim në zbatimin e strategjisë për reforma në gjyqësor, duke adresuar në ndërkohë "Prioritetet urgjente për reforma" dhe rekomandimet e Komisionit të Venedikut dhe Grupit të ekspertëve të lartë për çështje sistematike për sundimin e ligjit. Nevojiten edhe më shumë përpjekje që të sigurohet zbatimi sistematik i planit të përditësuar të veprimit të strategjisë për reforma gjyqësore. Institucionet gjyqësore zbatojnë rregulla të reja për zgjedhjen, avancimin, disiplinën dhe shkarkimin e gjykatësve, kurse Këshilli gjyqësor e kryen rolin e tij në mënyrë më aktive.

Në vitet e fundit, qeveria ka treguar respekt më të madh për pavarësinë dhe paanshmërinë

[37] Strategjia për reforma në sektorin e Drejtësisë 2017-2022 fq 5
[38] Po aty.
[39] How to a cleared judiciary and independent judges, EPI Institute, September 2020
[40] Sa është besimi në gjyqësor?, https://epi.org.mk/post/16083
[41] Ligji për ndryshimin e Ligjit për gjykatatat, Gazeta Zyrtare 96/19 nga 17 May 2019
[42] Kodi i Etikës për Gjykatësit dhe jurinë http://www.vsrm.mk/wps/wcm/connect/vsrm/
[43] https://akademik.mk/kluchnite-izmeni-na-zakonot-za-sudovite/
[44] Ligji për prokuorinë publike, Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 42/20 nga 16 Shkurti i vitit 2020
[45] www.pravdiko.mk/stapuva-na-sila-noviot-zakon-za-javnoto-obvinitelstvo/

e gjyqësorit se sa në të kaluarën dhe janë marrë aktgjykime për disa raste të mëparshme të nivelit të lartë të PSP-së.[46] Në pajtim me raportin e KE-së për vitin 2019, sistemi gjyqësorë i Maqedonisë së Veriut ka bërë një përparim të mirë në adresimin e reformave urgjente prioritare të BE dhe rekomandimeve nga Komisioni i Venedikut dhe Grupi i ekspertëve të lartë në Çështjet sistematike të sundimit të ligjit.

[46] www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/?fbclid=IwAR0qEo5sW_yXDsJFtyd2o6-ldNni_OPyQvYzSSrWE9ZwpPCx4kswpCxFDuQ

KONTEKSTI

Ky raport është një nga rezultatet e studimit (outpute) i projektit të financuar nga BE *Dhënia fund e pandëshkueshmërisë për korrupsionin e lartë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë* për të zvogëluar korrupsionin dhe kapjen e shtetit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Turqi. Projekti synon që të përmirësojë qeverisjen, transparencën dhe llogaridhënien e gjyqësorit dhe hartimin demokratik të ligjeve. Për të bërë një gjë të tillë, ne shohim mënyrat se si arrihet kapja e shtetit dhe si mirëmbahet gjendja e tillë duke nënvizuar mangësitë në sistemin e ndjekjes penale gjatë trajtimit të rasteve të korrupsionit të lartë, dhe shpalosjes të ligjeve të hartuara sipas nevojës për të mbrojtur interesin privat të elitës që është në numër të vogël.

Hulumtimi është kombinuar me fushatat e përfaqësimit të bazuar në dëshmi për të nxitur ndryshimin në çdo vend. Bashkë me raportin rajonal, rezultatet e projektit janë shtatë raporte nacionale dhe dy baza të të dhënave.[47] Një bazë e të dhënave grumbullon rastet e korrupsionit në rajon, në mënyrë specifike rastet e korrupsionit të lartë apo ata që mund të përfaqësojnë pikënisjen në kapjen e shtetit. Këto raste ilustrojnë sinjalet kritike dhe mangësitë në sistemin gjyqësorë të këtyre vendeve kur adresohet korrupsioni politik. Baza e dytë e të dhënave përfshin ligjet e hartuara sipas nevojës, ligjet që shërbejnë për të fituar dhe mbajtur privilegjet dhe në këtë mënyrë të bëjnë të ligjshme kapjen e shtetit. Kjo zbulon se në cilën mënyrë hartimi i ligjeve është përdorur për të mbrojtur interesat private. Bazat e të dhënave nuk janë paraparë për të qënë tërësisht gjithëpërfshirëse. Në vend të kësaj, ata përdorin qasjen cilësore për rastet e grumbulluara dhe ligjet, si mjete për të kuptuar se si sistemi gjyqësorë funksionon dhe si ndikohet mbi hartimin e ligjeve.

Ky projekt ndërlidhet me punën e mëparshme të Transparency International në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Hulumtimi i thellë i masave në luftën kundër korrupsionit[48] i realizuar nga Transparency International në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Serbi dhe Turqi ndërmjet viteve 2014 dhe 2015, ka vërtetuar kapjen e shtetit si një problem konsistent në të gjithë vendet. Hulumtimi pasues në rastet e kapjes të shtetit në sektorët specifik të secilit vend na ka mundësuar që të kuptojmë më mirë se ku ndodh kapja e shtetit dhe karakteristikat e saj. Tani, analiza se si çdo gjyqësor i shtetit adreson rastet e korrupsionit që mund të jetë pikënisje në kapje, dhe në cilën mënyrë ndikimi i panevojshëm në hartimin e ligjeve rezulton në ligje të hartuara sipas nevojës, na mundëson ne që të përgjigjemi në pyetjen se çfarë është ajo që mundëson kapjen e shtetit.

Për t'u ndërlidhur me hulumtimin tonë, ne po hartojmë rekomandime për reforma efektive kundër korrupsionit dhe sundimit të ligjit në këto vende.

---

[47] www.transparency.org/en/projects/grand-corruption-western-balkans-and-turkey

[48] Transparency International, *Fighting corruption in the Western Balkans and Turkey: priorities for reform*, 2016, https://images.transparencycdn.org/images/NISWBT_EN.pdf

METODOLOGJIA

Kapja e shtetit është një pengesë kryesore për efektivitetin e reformave kundër korrupsionit dhe sundimit të ligjit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Kjo ndodh kur aktorët publik dhe privat synojnë organet e caktuara shtetërore dhe funksionet duke përdorur mënyrat korruptive për të drejtuar vendimet e politikës publike larg nga interesi publik për të avancuar interesin e tyre personal privat, përfundimisht për përfitime financiar. Pandëshkueshmëria për korrupsion, dhe hartimi i ligjeve për të avancuar interesin privat të grupeve të veçanta apo individëve në kurriz të interesit publik, konsiderohen drejtues kryesor të kapjes të shtetit.

Analiza jonë kosideron disa burime të informacionit: të dhënat parësore të grumbulluara në rastet e korrupsionit dhe ligjet e hartuara sipas nevojës; vlerësim i mëparshëm i korrupsionit, kapjes të shtetit dhe sundimit të ligjit në rajon nga Sistemi i integritetit nacional të Transparency International, Komisioni Europian, Grupi i shteteve kundër korrupsionit dhe UNCAC, dokumentet zyrtare, artikujt në media, dhe literatura e specializuar.

Grumbullimi i të dhënave origjinale në rastet dhe ligjet e ka mbuluar periudhën e 10-12 viteve të fundit me qëllim të identifikimit të varianteve të mundshme të sjellura nga ndryshimet në qeveri pas zgjedhjeve. Zgjidhja e rasteve të korrupsionit për hulumtimin tonë ka ndjekur tre kritere. I pari është që të përfshijë çfarëdo rasti të korrupsionit që përputhet me përkufizimin e Transparency International për korrupsionin e lartë. Kjo mbulon veprat penale në Nenet 15-25 të Konventës të Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) të kryera si pjesë e planit që përfshin zyrtarët publik të nivelit të lartë dhe që përfshin një keqpërdorim të konsideruar të fondeve publike apo mjeteve, apo kufizim serioz të të drejtave themelore të njeriut për një pjesë të konsiderueshme apo të rrezikuar të popullsisë.

Megjithatë, meqënëse përkufizimi ligjor paraqet kufizime për hulumtim të fenomenit kompleks politik, ne kemi zgjeruar kriterin për të përfshirë rastet që tregojnë mungesën e autonomisë, pavarësisë dhe paanshmërisë të gjyqësorit, dhe si kriteri i tretë, rastet që shërbejnë si pikënisje për kapjen e shtetit.

Treguesit për të konsideruar një rast si pikënisje për kapjen e shtetit përfshijnë rastet:

- Kur një deputet apo zyrtarë me pushtet për hartim të ligjit apo krijimit të politikave është përfshirë në kapacitet të tillë në veprat penale
- Kur një marrës i vendimeve i nivelit të lartë në trup rregullator është përfshirë në kapacitet të tillë në veprat penale
- Kur veprat e pretenduara penale përfshijnë zyrtarin publik që ka fituar pozitën e tij përmes një situate të “derës të rrotullimit”
- Kur veprimi i cilitdo prej tre kategorive i shërben interesit të personit juridik apo grupit apo rrjetit të ngushtë të personave të lidhur, dhe jo interesit të aktorëve tjerë në sektor, grupit tjetër social apo interesit publik
- Rastet që lidhen me ligjet e hartuara sipas nevojës.

Të tre kriteret kanë të përbashkët përfshirjen e të paktën një zyrtari publik që ka pushtetin për të ndikuar apo ndryshuar politikat dhe rregullat. Në shumicën e rasteve, zyrtarët politik kanë mbajtur role të përgjegjësisë të lartë në institucionin e nivelit shtetërorë, siç janë ministritë. Megjithatë, duke patur parasysh se realiteti politik në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi karakterizohet nga fuqia e partive politike dhe anëtarëve të partisë në komunat e caktuara, janë përfshirë gjithashtu rastet e korrupsionit që përfshin kryetarët e komunave të

fuqishëm respektivisht me pushtet apo institucionet tjera lokale.

Ligjet e hartuara sipas nevojës si akte ligjore të hartuara që t'i shërbejnë vetëm interesit të personit fizik, personit juridik apo grupit apo rrjetit të ngushtë të personave të lidhur, dhe jo interesit të aktorëve tjerë në sektorë, grupit tjetër social apo interesit publik. edhepse ligjet e hartuara sipas nevojës duket se janë në përgjithësi të zbatueshme, ata zbatohen vetëm për çështjen e caktuar dhe shmangin mjetet juridike që mund të ofrohen nga gjykatat e rregullta.

Duke u bazuar në këtë përkufizim, ne kemi shtruar këto pyetje me qëllim që të identifikohen ligjet e hartuara sipas nevojës: kush qëndron prapa ligjit? A kishte parregullsi në përgatitjen apo miratimin e ligjit? Kush ka përfituar apo kush ka humbur nga ligji?

Ne kemi konsideruar tre lloje të ligjeve të hartuara sipas nevojës, që janë hartuar të: 1) kontrollojnë sektorin apo industrinë, apo të mbrojnë privilegjet e caktuara 2) për të arritur pandëshkueshmërinë për korrupsion , dhe 3) të zvogëlojnë pushtetin ekzekutiv për të ushtruar mekanizmat e kontrollit përmes kontrollimit të procedurave të personelit, duke zvogëluar kapacitetin e monitorimit të agjencive apo revizorëve, duke parandaluar llogaridhënien, apo dobësimin e mundësive për kryerjen e mbikëqyrjes nga ana e media dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC).

Edhepse nuk ofron një fotografi gjithëpërfshirëse të situatës, ky raport ofron një qasje cilësore dhe ndërlidhet me përpjekjet më të mira të bëra nga degët dhe partnerët e Transparency International në rajon në identifikimin e rasteve dhe ligjeve dhe për grumbullimin e informacionit të detajuar. Detaje për rastet e korrupsionit dhe ligjet e hartuara sipas nevojës të përmendura në këtë raport mund të gjenden në bazat e të dhënave.[49]

[49] www.transparency.org/en/projects/grand-corruption-western-balkans-and-turkey

GJETJET DHE DISKUTIMI

KORRUPSIONI I LARTË ËSHTË PROBLEMI MË I MADH

DEKLARATË NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË MAQEDONISË SË VERIUT, STEVO PENDAROVSKI

"Problemi më i madh në vendin tonë është korrupsioni. Në gjithë këto vite, nuk ka patur aktgjykim për zyrtarët e nivelit të lartë apo person tjetër të përfshirë në korrupsionin e lartë. Ata në pushtet gjithmonë shohin nga e kaluara dhe nuk i kushtojnë vëmendje asaj që po ndodh sot. Por edhe në ato raste nuk ka aktgjykim efektiv apo sanksionet e shqiptuara janë shumë të ulëta."

TV Telma, Intervistë, 15 Tetor 2020

Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut nuk përkufizon "korrupsionin e lartë," por fraza është përdor shpesh në vend për të përshkruar rastet që përfshijnë zyrtarët me pushtet dhe dëmet e larta. Kodi penal udhëzon në vepra të shumta penale që lidhen me korrupsionin,[50] ndërsa Ligji për parandalimin e korrupsionit apo konfliktit të interesit përkufizon korrupsionin si keqpërdorim të funksionit, kompetencave publike, detyrës apo pozitës zyrtare për përfitim, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes ndërmjetësuesit, për veten apo personin tjetër.[51] Maqedonia e Veriut është një nga shtetet e pakta që inkriminon përfitimin e kundërligjshëm dhe fshehjen e pronës[52] si dhe dhënien apo pranimin e dhuratave për ndikimin e kundërligjshëm.[53], inkriminimi nga Maqedonia e Veriut i akteve korruptuese përputhet kryesisht me Konventën e UNCAC.[54]

Për këtë projekt, TI Maqedoni ka analizuar 30 raste që përmbushin përkufizimin e korrupsionit të prezantuara në seksionin e Metodologjisë. Shumica e këtyre rasteve janë hetuar nën PSP-në tashmë të shfuqizuar dhe janë transferuar në Prokurorinë Publike; dhe përfshijnë keqpërdorimin e pushtetit nga politikanët e nivelit të lartë.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË RASTEVE TË ANALIZUARA

Ne kemi identifikuar rastet penale që përfshijnë zyrtarët - krijues të politikave rregullatorë

[50] Më shumë se 20 vepra penale: siç janë: evazioni fiskal (Neni 270 i Kodit Penal), pranimi i rryshfetit (Neni 357 i Kodit Penal), dhënia e rryshfetit (Neni 358 i Kodit Penal), keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar (Neni 353 i Kodit Penal), përvetësimi në shërbim (Neni 356 i KP), falsifikimi i dokumentit zyrtar (Neni 361 i Kodit Penal), Puna e pakujdesshme në shërbim (Neni 353c i Kodit Penal), mashtrimi i blerësve (Neni 248 i Kodit Penal), mashtrimi i sigurimeve (Neni 250 i Kodit Penal), keqpërdorimi i procedurës për thirrjen publike, dhënien e marrëveshjes për prokurim publik apo partneriteti publik-privat (Neni 275c i KP), Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (Neni 362 nga KP), janë konsideruar

[51] https://dksk.mk/fileadmin/user_upload/Zakon_za_sprecuvanje_na_korupcija_i_sudirot_na_interesi.pdf Neni 2

[52] Neni 359-1 i KP

[53] Neni 358-a i KP

[54] www.slvesnik.com.mk/Issues/90E0B29D702D49A48DBCC2239374B927.pdf www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/

veprimi i pretenduar i të cilëve i ka shërbyer interesit të ngushtë të grupit apo rrjetit të personave të lidhur dhe jo interesit publik. Përveç kësaj, disa raste të analizuara kanë përfshirë ligjet e hartuara sipas nevojës. Në shumicën e rasteve, zyrtarët e akuzuar kanë patur rol të rëndësishëm në institucionet e nivelit shtetërorë, siç janë ministritë. Janë përfshirë gjithashtu disa raste të korrupsionit që përfshin kryetarët e fuqishëm të komunave dhe pushtetet tjera lokale.

Vepra penale më e zakonshme ishte keqpëdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar. Akuzat tjera të zakonshme ishin larja e parave dhe pranimi i dhuratës për ndikim të kundërligjshëm. Përkundër përsëritjes të një grupi të vogël të personave në shumë raste, organizata penale nuk ishte një vepër penale e zakonshme.

GRAFIKONI 1 : SHEMBULLI I RRJETEVE TË PËRFSHIRA NË RASTET E KORRUPSIONIT TË NIVELIT TË LARTË



Në rastet e analizuara kishte 233 të akuzuar. Të gjithë të dyshuarit në rastet e analizuara ishin zyrtarë të nivelit të lartë, duke përfshirë:

- Ish Kryeministrin Nikolla Gruevski. Ai ishte i dyshuar në dhjetë raste (Traektorja, Banka postare, Tanku, Talir, Propaganda, TNT, Talir 2, Titanik, Dhunë në Qendër, Aktor) dhe është akuzuar për keqpërdorim të detyrës, larje të parave dhe vepra tjera penale. Ai është dënuar deri në dy vite në rastin Tank dhe një vit e gjashtë muaj në rastin Dhunë në Qendër. Megjithatë, ai nuk është në vuajtje të dënimit me burg sepse ai është larguar në Hungari, ku edhe i është dhënë azil politik.

- Ministri i mëparshëm i Transportit Mile Janakievski. Ai ishte i dyshuar në njëmbëdhjetë raste (Traektorja, Talir, TNT, Titanik, Dhunë në Qendër, Toplik, Dhurata, 27 Prill, Shkallët spanjolle, Aktor, Dizajni) dhe është akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, larje të parave, vepra penale që lidhen me zgjedhjet, organizimi i organizatës kriminale, dhe vepra tjera. Deri tani, ai ka qënë i dënuar vetëm për rolin e tij në Dhunën në Qendër dhe i është shqiptuar dënim me burg me kusht prej një viti. Rastet tjera janë në vijim e sipër.

- Drejtori i mëparshëm i Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim (DSK) Sasho Mijallkov. Ai ishte i dyshuar në pesë raste (Fortesa-Target, Thesari, Titanik 2, Tortura, Perandoria) dhe është akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ndërmjetësim, larje të parave, organizim të organizatës kriminale, dhe vepra tjera penale. Ai ishte dënuar me tre vite dënim me burg në rastin Titanik 2 por gjykata e apelit e ka shfuqizuar aktgjykimin dhe ka ritkthyer rastin për rigjykim. Atij ishte shqiptuar denim me burg prej 12 vitesh në rastin Fortesa-Target për keqpërdorim të detyrës zyrtare, organizatës kriminale, dhe pranim të dhuratës për ndikim të kundërligjshëm, por vendimi nuk ishte përfundimtar. Rastet tjera janë në vijim e sipër.

- Kryeministri i mëparshëm Ljubço Georgievski. Ai ishte i dyshuar në dy raste (Traektorja dhe Banka postare) dhe është akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Vepra penale e Bankës postare është vjetërsuar.

- Ndihmësi i mëparshëm i ministrit në Ministrinë e punëve të brendshme Gjoko Popovski. Ai ishte i dyshuar në dy raste (Tanku dhe Treqind) dhe ishte i akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Në rastin Tanku, atij i ishte shqiptuar dënim me burg prej gjashtë vitesh e gjashtë muajsh në burg, të cilin dënim e ka zvogëluar gjykata e apelit në katër vite e gjashtë muaj. Në rastin Treqind (trista), atij i është shqiptuar dënim me burg prej 9 vitesh.

- Ministri i mëparshëm i punëve të brendshme Gordana Jankulovska. Ajo ishte e dyshuar në tre raste (Fortesa - Target, Titanik, dhe Tank) dhe akuzohej për keqpërdorim të pozitës zyrtare, krijim të organizatës kriminale, shkelje të të drejtave zgjedhore, dhe vepra tjera penale. Në rastin Tanku, ajo ishte dënuar me gjashtë vite burgim, të cilin dënim gjykata e apelit e ka zvogëluar në katër vite burg. Ajo gjithashtu ishte dënuar me katër vite burg në rastin Fortesa-Target por aktgjykimi nuk është i plotëfuqishëm.

- Shefi i mëparshëm në Ministrinë e punëve të brendshme Goran Gruevski. Ai ishte i dyshuar në dy raste (Fortesa-Target dhe Thesari) dhe i akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, krijim të organizatës kriminale, dhe falsifikim të dokumenteve zyrtare. Ai është dënuar me dënime me burg prej 15 vitesh në rastin Fortesa-Target, por aktgjykimi nuk është i plotëfuqishëm dhe ai u largua nga vendi.

KAPJA E SHTETIT NË RASTET E ANALIZUARA

Demonstrimi më i qartë i kapjes të shtetit në Maqedoninë e Veriut është rasti i Shkupit 2014, i cili ende është në pritje të ndjekjes penale. Ky rast ka përfshirë shpenzimet e vlerësuara prej 685 milion eurove para publike në monumente të mëdha në kryeqytetin e Shkupit. Ministria e Kulturës ka transferuar fondet te komunat për projektet e inicuara nga këshillat komunal. Qeveria ka zgjedhur që të punojë përmes këshillave komunal të komunave me qëllim që të përjashtojë Parlamentin, që ka kërkuar një shumicë të dyfishtë të cilën nuk mund ta siguronte koalicioni në pushtet.

Rasti i studimit – ndërtimi i projektit "Shkupi 2014" i referohet mënyrave dhe mekanizmave të përdorura për të arritur qëllimin përfundimtar, ndërtimin e 137 objekteve me vlerë prej 685 milion EURO, fonde nga Buxheti i Republikës të Maqedonisë. Mënyra e realizimit të projektit i referohet ekzistimit të një sërë lëshimesh të formave të ndryshme në zhvillimin e procedurës dhe ndërtimin e objekteve, shkelje individuale të ligjit në lidhje me secilin nga ndërtimet e planifikuara. Janë bërë ndryshime të shpeshta të ligjeve, nga të cilat një numër i konsideruar në procedurat e shkurtra, integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit janë prishur, kishte presion mbi mediat, shkelje të ligjeve dhe selektivitet, të kryer në mënyrë masive nga pushteti ekzekutiv. Janë dorëzuar disa amandamente në ligje dhe akte nënligjore – në periudhën prej e viteve 2007-2015, me qëllim që të bëhet një përpjekje për të mbuluar ligjërisht ndërtimet. Praktikisht të gjithë ligjet ishin me iniciativë të Qeverisë të RMV, dhe të miratuara nga Parlamenti, që kontrollohej tërësisht nga qendra politike e pushtetit ekzekutiv, ndërsa ligjet e tilla ishin miratuar në interes të realizimit të projektit. E tërë procedura ishte kryer në mënyrë jotransparente dhe subtile, me miratimin e vendimit dhe iniciativave në nivel qëndror dhe lejeve të ndërtimit në nivel lokal, duke drejtuar paratë për këtë qëllim nga buxheti qëndror në llogarinë e Komunës Qendër. Prokurimet (furnizimet) publike ishin kyer në mënyrë jotransparente – shpesh duke shfrytëzuar mundësinë për të lidhur anekse dhe marrëveshjeve për realizimin e punëve shtesë dhe të paparashikuara. Në këtë mënyrë, vlera e llogaritur në fillim për ndërtimet është rritur disa herë.[55]

Shumë prej rasteve të analizuara për këtë projekt, siç janë TNT, Talir, Trajektorja, Thesari, dhe Perandoria, gjithashtu tregojnë kapjen e shtetit. Rasti TNT[56] ka përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë që keqpërdorin pushtetin dhe autoritetin e tyre politik për përfitim të tyre. Aktakuza pretendon se kryeministri i mëparshëm Nikola Gruevski ka urdhëruar shkatërrimin e ndërtesës afariste dhe banesore pronari i të cilës ka braktisur koalicionin qeveritar në vitin 2011. Sipas prokurorëve të PSP-së, vendimi i komunës për të shkatërruar ndërtesën është bazuar në një raport të falsifikuar të inspektimit. Të akuzuarit tjerë të rastit përfshijnë Ministrin e transportit dhe lidhjeve, i cili ka koordinuar detonimin e kundërligjshëm, dhe kryetarin e mëparshëm të komunës të Gazi Babës në Shkup. Ky rast gjithashtu tregon joefikasitetin e prokurorëve dhe gjyqësorit. Prokuroria publike nuk ka ngritur ndonjë aktakuzë deri në qershor të vitit 2017, pas ndryshimit të qeverisë. Në tetor të vitit 2017, PSP-ja ka marrë kompetencën lëndore[57] mbi këtë rast. Tani rasti është para PTHPKOK.

Në rastin e Trustit, një sërë amendamentesh në ligj dhe akte nënligjore kanë mundësuar pandëshkueshmërinë e djalit të deputetit. Në rastet Tanku dhe Trajektorja, procedurat e prokurimit publik ishin realizuar në mënyrë jotransparente. Zyrtarët publik kanë përdorur pushtetin e tyre për të përfituar një rreth i ngushtë i njerëzve të besuar duke shmangur

[55] Kapja e shtetit – ilustrim përmes projektit "Shkupi 2014" https://www.transparency.mk/en/images/stories/publications/state_capture.pdf

[56] Prokuroria publike i emërtonte lëndët në bazë të asociacioneve. Në këtë rast, llojit të eksplozivit.

[57] Me 26 biseda telefonike dhe 57 porosi me tekst, Prokuroria Special ka dëshmuar sot në gjykatë shkatërrimin e kundërligjshëm të objektit Kozmos. https://sitel.com.mk/prodolzhi-sudenjeto-za-sluchajot-tnt-odbranata-negoduva-za-snimkite-za-sjo-tie-se-dokaz-za

sistemin e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

Rasti Talir ishte hetimi i parë për korrupsionin lidhur me financimin e partisë politike. Rasti ka përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë në partinë politike të cilët gjithashtu kanë qënë në qeveri dhe kanë keqpërdorur pozitën dhe autorizimin e tyre zyrtar. Ish kryeministri Nikolla Gruevski dhe bashkëpunëtorët e tij ishin akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe larjes të parave. Një nga bashkëpunëtorët ka pranuar fajësinë. Sipas aktgjykimit, grupi ka larë reth 5 milion euro. Sipas PSP-së,[58] ka dyshim të bazuar se paratë e kundërligjshme ishin depozituar në llogarinë bankare të partisë si para të gatshme. Prejardhja e parave ende nuk është përcaktuar. Supozohet se të akuzuarit kanë keqpërdorur të dhënat personale të anëtarëve të partisë për të bërë pagesa individuale nga llogaria e partisë. Të gjithë pagesat e dyshimta janë bërë në periudhën ndërmjet viteve 2009 dhe 2015.

Analiza gjithashtu ka vërtetuar joefikasitet të prokurorëve, të cilët kanë dështuar që të inicojnë hetimet para krijimit të PSP-së. Për këtë arsye, në disa raste ka ardhur deri te skadimi i afatit të parashkrimit. Në rastin e Shkupit 2014, kryetari i ri komunës të Shkupit ka iniciuar një revizion.[59] Ai ka prezantuar dy raporte të revizionit në prokurori, por PP-ja nuk ka filluar hetimin dhe nuk ka ngritur akuza.

Një i akuzuar i nivelit të lartë gjithashtu ka shmanguar vuajtjen e dënimit me burg në rastin Tanku nga viti 2007. Ish Kryeministri Vllado Buckovski në fillim i është shqiptuar sanksion prej 2 vitesh burg, por pas disa shtyrjeve dhe ankesave rasti është parashkruar në fillim të gjykimit të tij të tretë.[60]

PROCEDURAT E KORRUPSIONIT TË LARTË NË GJYKATA

PENGESAT PËR NDJEKJEN PENALE DHE PËRPARIMIN E RASTEVE NË PROCEDURËN GJYQËSORË

Ne kemi identifikuar disa aspekte joefektive procedurale në pothuajse çdo rast: mospërmbushja e afateve për të filluar shqyrtimi kryesor pas dorëzimit të aktakuzës; procedura jashtëzakonisht të gjata; rifillimi i gjykimeve nga fillimi; mungesa e personave prania e të cilëve ishte e domosdoshme; vendime të ngadalshme për dëshmitë e pranueshme; dhe përbërje jo e tërësishme e këshillit gjyqësorë.

PROCEDURAT JASHTËZAKONISHT TË GJATA

Vonesat janë dukuri të zakonshme në procesin gjyqësorë. Në të gjithë përveç në njërin rast të analizuar, afati për të filluar shqyrtimin kryesorë pas vërtetimit të aktakuzës nuk është përmbushur. Sipas LPP; kryetari i këshillit të gjykatës të shkallës të parë duhet të caktojë shqyrtimin kryesorë brenda 30 ditëve nga pranimi i aktakuzës (apo 60 ditë për aktakuzat që përfshijnë krimin e organizuar).[61] Në rastet e analizuara në raportin e OSBE,[62] koha mesatare nga vërtetimi i aktakuzës deri në fillim të gjykimit ishte më e gjatë se 60 ditë. Procesi në shumë raste ka zgjatur pesë deri në gjashtë muaj.

---

[58] Po aty

[59] Raporti i parë për përfshirjen e Komunës Qendër në projektin “Shkupi 2014”, Përgatitur nga: Slagjana Taseva, doktor shkence (PhD) dhe Dragan Malinovski http://opstinacentar.gov.mk/LinkClick.aspx?fileticket=FFWpQbLwYvcper cent3d&portalid=0&language=mk-MK Raporti i dytë për situatën aktuale me realizimin e projektit “Shkupi 2014” përmes Komunës Qendër – Prokurimi publik për dizajnin e monumenteve Raporti i dytë për përfshirjen e Komunës Qendër në projektin “Shkupi 2014” http://opstinacentar.gov.mk/Portals/0/Documentatin/Banners/izvestajper cent20IIper cent2024.11.2013.pdf

[60] https://sdk.mk/index.php/makedonija/zastare-deloto-na-buchkovski-za-tenkovski-delovi/

[61] http://www.slvesnik.com.mk/Issues/BDBF29F810D5E9468FC65FA542B857B3.pdf Article 345, page 58

[62] https://www.osce.org/files/f/documents/0/7/391745_0.pdf

Për shkak të vonesave, është bërë parashkrimi gjashtëvjeçar për ish Kryeministrin Nikolla Gruevski në rastin Trajektorja në 31 tetor të vitit, 2019.[63] Gruevski është akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, në lidhje me dhënien e kundërligjshme të tenderit për ndërtimin e autostradës.[64] Sipas PSP-së, Gruevski ka dhënë një kontratë me vlerë prej 570 milion euro një kompanie kineze[65] edhepse një kompani tjetër kineze ka dorëzuar një ofertë më të ulët për të njëjtën punë. Vepra penale e pretenduar është kryer në vitin 2012, por gjykimi vazhdimisht shtyhej për shkak të pengesave në gjykatë, siç janë ndryshimet në përbërjen e këshillit gjyqësorë.

Ndryshimet në përbërjen e Këshillit Gjyqësorë ishin shkak i shpeshtë për shtyrjen e seancave. Aktakuza në rastin Fortesa-Target është ngritur në qershor të vitit 2017 dhe gjykimi i parë ka filluar pas gjysëm viti; por ndryshimi në Këshillin gjyqësorë në janar të vitit 2018 u ka kërkuar atyre që të rifillojnë gjykimin nga fillimi.[66]

MANGËSITË NË VLERËSIMIN E LEJUESHMËRISË TË DËSHMIVE PARA GJYKIMIT

Gjykatësit nuk kanë gjithmonë autorizimin për të përcaktuar lejueshmërinë e dëshmisë të propozuar gjatë gjykimeve. Megjithatë, shumë prej tyre kanë mundësuar të gjithë dëshmitë e propozuara pa bërë një vlerësim të ndarë të lejueshmërisë të tyre para gjykimit. Dështimi që të adresohen dhe zgjidhen çështjet procedurale gjatë procedurës paraprake (psh. Kundërshtimet në lidhje me lejueshmërinë e dëshmive apo ankesave në lidhje me procesin e ndarjes të dëshmive) kanë rezultuar me diskutime të gjata të këtyre çështjeve gjatë shqyrtimeve kryesore, e kështu është vonuar e paraqitja e dëshmive.

Seancat gjyqësore janë shtyrë shpesh për shkak të ngurrimit të gjykatësve që të ndërmarrin rol aktiv në menaxhimin e rasteve. Gjykatësit shpesh janë tërhequr gjatë përzgjedhjes të dëshmitarëve dhe prezantimit të dëshmive relevante materiale gjatë gjykimeve. Shpesh PSP-ja ka dështuar që të ofrojë informacion për kontekstin në të cilin kanë ndodhur bisedat e përgjuara dhe porositë me tekst. Në rastet si Tanku, Trusti, Trajektorja, PSP-ja nuk ka zbuluar emrat e personave të përgjuar në audio regjistrimet. Pa ndonjë shpjegim nga PSP-ja, shpesh herë ishte e vështirë për gjykatësit dhe publikun që të kuptojnë përmbajtjen e shumë prej bisedave të përgjuara dhe porosive. Në rastin Trajektorja, prokurorët nga PSP-ja kanë lexuar pothuajse 260 porosi gjatë tre orëve. Edhepse porositë kanë theksuar emrat e dërguesve dhe pranuesve, shumë kanë përmbajtur shkurtesa ose fjalë të koduara të cilat nuk janë shpjeguar.

MUNGESA E TË AKUZUARIT SI ARSYE KRYESORE E SHTYRJEVE

Mungesa e të akuzuarve ishte shkaku kryesor i shtyrjeve të rasteve të PSPsë.[67] Në 316 seancat e monitoruara nga OSBE ndërmjet Nëntorit të vitit 2016 dhe Nëntorit të vitit 2018, të paktën një i akuzuar ka munguar 46 herë (14 përqind), dhe 44 nga 104 shtyrje ishin për shkak të mungesës të të akuzuarit.[68] Për shembull, seancat në rastin Talir ishin shtyrë nëntë herë sepse disa nga të akuzuarit kanë munguar shpesh.[69]

---

[63] Te Trajektorija, ish Kryeministri Gruevski është akuzuar me keqpërdorim të detyrës zyrtare, në lidhje me dhënin e kundërligjshme të tenderit për ndërtimin e autostradës. Sipas aktakuzës, vepra penale ishte kryer në periudhën ndërmjet tetorit të vitit 2012 dhe tetorit të vitit 2013. Duke u bazuar në datën e fundit të kryerjes të veprës penale, 31 tetor i vitit 2013, parashkrimi absolut duhet të zbatohet pas gjashtë vitesh. Rrjedhimisht, kjo tregon se parashkrimi skadon në datë 31 tetor të vitit 2019.

[64] https://www.pravdiko.mk/gruevski-nema-da-odgovara-za-traektorija-poradi-zastarenost-na-deloto/

[65] https://balkaninsight.com/2017/05/22/macedonia-prosecution-suspects-former-pm-of-money-laundering-05-22-2017/

[66] https://prizma.mk/sluchajot-target-tvrdina-na-brza-pruga/

[67] https://www.osce.org/files/f/documents/a/e/422567_0.pdf

[68] https://www.osce.org/files/f/documents/a/e/422567_0.pdf

[69] Kush dhe pse dëshiron që të varros “Talir”? https://irl.mk/koj-i-zoshto-saka-da-go-zakopa-talir/

Ligji për Procedurën Penale kërkon, si rregull të përgjithshme, që gjykimi duhet të mbahet në prani të të akuzuarve. Një i akuzuar mund të gjykohet në mungesë (*in absentia)* nëse ai apo ajo është larguar nga vendi apo nuk është i qasshëm në ndonjë mënyrë tjetër për institucionet shtetërore, apo nëse ka "arsye të rëndësishme të veçanta" jo specfike për të mbajtur gjykimin.[70] Gjykata duhet të lëshojë vendim për gjykimin e të akuzuarit në mungesë pas kërkesës për ndjekje dhe një ankesë të këtij vendimi nuk parandalon vazhdimësinë e gjykimit në mungesë.[71]

Pasiqë ish Kryeministri Gruevski në mënyrë të kundërligjshme është larguar nga vendi dhe ka marrë azil në Hungari, PSP-ja ka propozuar që ai të gjykohet në mungesë në rastin TNT. Këshilli gjykues ka miratuar propozimin. Megjithatë fillimi i gjykimit është ende në pritje para gjykatës sepse të akuzuarit tjerë kanë shtyrë me sukses seancat.

Në rastin Thesari, katër zyrtarë nga Shërbimi i kundërzbulimit dhe Ministria e Punëve të Brendshme ishin akuzuar për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar në blerjen e pajisjes me vlerë prej 860.000 Euro. Dy të akuzuarit kryesor janë larguar nga vendi në Greqi dhe Gjykata Supreme e Athinës ka vendosur kundër ekstradimit për shkak të aktit të faljes të lëshuar nga Presidenti Gjorgje.[72]

PARABURGIMI DHE REFUZIMI I MASAVE TË KUJDESIT

Një studim i realizuar para themelimit të PSP-së ka treguar se gjykatat kanë miratuar shpesh paraburgimin e të akuzuarve dhe kanë refuzuar ankesat për të zëvenduar paraburgimin me ndonjë masë alternative të sigurisë.[73]

Megjithatë, gjykatat kanë vendosur që të jenë më të vëmendshme në rastet e PSP-së. Edhepse paraburgimi shpesh propozohej për të siguruar praninë e të dyshuarve, gjykatat shpesh e kanë refuzuar atë. PSP-ja ka kërkuar paraburgim në 11 nga rastet e analizuara për gjithsej 56 të dyshuar. Gjykatat kanë miratuar paraburgimin në nëntë raste për 30 të dyshuar. Gjykatat kanë refuzuar paraburgimin për 24 të dyshuar dhe kanë vendosur dy në burg shtëpiak. Në vend të paraburgimit, gjykatat kanë shqiptuar masa më pak kufizuese parandaluese siç është detyrimi për t'u paraqit në gjykatë, konfiskimi i përkohshëm i pasaportave, dhe ndalimi në lëshimin e pasaportave të reja.

Rasti Perandoria ishte hetimi i vetëm ku pesë të dyshuarit ishin arrestuar në fazën e hershme. Pas një muaji, parburgimi i tyre është zëvendësuar me burg shtëpiak. Gjykata më vonë ka shfuqizuar masën e burgut shtëpiak për tre të akuzuar, duke përfshirë Sasho Mijallkovin, Drejtorin e mëparshëm e drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim. Mijallkov ishte gjithashtu i gjykuar në rastin Fortesa - Target ku Gjykata Themelore Penale ka kërkuar burg shtëpiak për Sasho Mijallkoivin derisa të shqiptohet aktgjykimi dhe ai nuk ishte i disponueshëm për të pranuar vendimin për paraburgim të lëshuar nga gjykata një ditë para vendimit. Sasho Mijallkov nuk ishte në dispozicion për institucionet, dhe policia dështoi që të dorëzojë vendimin për burgun shtëpiak për të. MPB ka lëshuar urdhërarrest kombëtar dhe ndërkombëtar. Dy ditë pasiqë ai nuk ishte në dispozicion për institucionet, ai është paraqitur para Prokurorisë Publike. Largimi kontravers (më vonë i shpjeguar si padisponueshmëri për të komunikuar për shkak të temperaturës të lartë) ishte vazhduar me një rikthim edhe më kontravers[74] ku i ndjekur nga mediat, Mijallkovi ishte drejtuar për të pranuar (marrë) vendimin gjyqësorë

[70] Në pajtim me LPP, Art. 365(3),

[71] Në pajtim me LPP, Neni 365(4),

[72] Иванов го востоличи разминувањето на правото и правдата, Deutsche Welle, https://p.dw.com/p/1J3QK, 09.06.2016. Уставниот суд го затвори прашањето за аболициите на Иванов, на потег е Стразбур, Deutsche Welle https://p.dw.com/p/3lWcn, 19.11.2020

[73] pod_lupa.pdf (transparency.mk)

[74] https://www.mkd.mk/makedonija/sudstvo/sasho-mijalkov-stilskiot-begalec-shto-otide-za-da-se-vrati

për burgun shtëpiak nga prokuroria në vend se nga gjykata. Në të njëjtën kohë, prokuria ka tërhequr ankesën e parashtruar në gjykatën e apelit, duke kërkuar për Mijallkovin masë paraburgmi në vend të burgut shtëpiak. Ky rast ka provokuar një reagim të gjërë publik, MPB ka lëshuar një urdhërarrest dhe përfundimisht qeveria ka inicuar hetimin për të gjetur gabimet në procedurë dhe për përcaktimin e përgjegjësisë.

PUNA E PROKURORËVE

Prokurori publik (PP) është përgjegjës për hetimet dhe grumbullimin e dëshmive (duke përfshirë edhe dëshmitë e lira) dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Fakti se prokurorët publik nuk kanë arritur që të hetojnë rastet të cilat shihen si "raste politike" dhe besohej se në raste te tilla lihen anash standardet e zakonshme, që ishte thelbësore për krijimin e PSP. Gjithashtu, kjo çon në atë se në gjyqësor nuk duhet të ekzistojë ajo që njihet si "rast politik".

Kjo analizë nuk mund të vërtetojë se kjo gjendje është ndryshuar dhe i është lënë të kaluarës. Në Maqedoninë e Veriut, Prokurori Publik (PP) është përgjegjës për hetimin dhe grumbullimin e dëshmive (duke përfshirë provat në favor të të dyshuarit)[75] dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.[76]

Qasja e mbrojtjes në dosje mund të kufizohet vetëm për të mbrojtur të drejtat themelore të palëve të treta (për shembull, dëshmitarët që rrezikohen nga hakamarrja) apo për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik (psh.sigurinë nacionale). PSP-ja i ka mundësuar mbrojtjes që të inspektojë dosjet menjëherë pas hetimit të tyre. Gjithashtu u ka dhënë avokatëve mbrojtës disqet me dëshmi të grumbulluara në mbështetje të akuzës. Kjo praktikë është në pajtim me standardet për gjykim të drejtë dhe të barabartë.

PSP-ja gjithashtu është kujdesur që të informojë publikun për hetimin e saj. Megjithatë, bisedat e përgjuara kanë krijuar sfidat për PSP-në kur prezantojnë dëshmi në gjykatë. Prokurorët kanë dorëzuar regjistrimin e bisedave të përgjuara si dëshmi në pothuajse çdo rast. Në tre raste—Titanik 1, Trajektorja, dhe TNT— PSP-ja gjithashtu ka përfshirë mbi 1,000 porosi me tekst (SMS) të cilat janë ndjekur si dëshmi. Porositë ishin projektuar në ekran dhe ishin lexuar me zë në gjykatë, por ishte e vështirë për gjykatësit dhe publikun të kuptojnë përmbajtjen e shumë bisedave të përgjuara pa shpjegim përkatës nga prokurorët. Në disa situata, e gjithë seanca ka kaluar duke dëgjuar bisedat e përgjuara pa ndonjë informacion për kuptimin e tyre apo lidhjen me faktet kryesore në rastin e veçantë. PSP-ja nuk ka bërë gjithmonë zgjidhjen e duhur për bisedat më të inkriminuara, dhe disa prej bisedave nuk ishin relevante për rastin konkret. Situata ishte më konfuze kur nuk ishin theksuar emrat e personave që merrnin pjesë në bisedë.

AKTGJYKIMET

Disa raste të korrupsionit të lartë kanë përfunduar me aktgjykim. Megjithatë, sanksionet ishin të buta dhe disa herë janë ulur në procedurat në shkallë të dytë.[77] Sanksioni i një të akuzuari prej nëntë vitesh burg në rastin Treqind ishte ulur në pesë vite nga një ankesë ndaj vendimit të gjykatës në 16 nëntor të vitit 2020.[78] I njëjti person ishte i akuzuar në dy raste dhe

[75] http://www.slvesnik.com.mk/Issues/BDBF29F810D5E9468FC65FA542B857B3.pdf Article 291, paragraph 4
[76] http://www.slvesnik.com.mk/Issues/BDBF29F810D5E9468FC65FA542B857B3.pdf Article 29, paragraph 2
[77] Ju lutemi shihni shpjegimin në Ligjet e hartuara sipas nevojës
[78] https://libertas.mk/apelaci-a-a-namali-kaznata-na-oko-popovski-od-9-na-5-godini-za-slucha-ot-trista/

tashmë është në vuajtje të dënimit me burg për rastin Tanku për blerjen e kundërligjshme të Mercedesit të klasit të lartë për ish Kryeministrin.[79] Të akuzuarit më të shquar në rastin Tank janë ish Ministri i Punëve të Brendshme Gordana Jankulovska, që ka filluar vuajtjen e dënimit me burg në 28 shtator të vitit 2020, dhe ish Kryeministri Nikolla Gruevski që është larguar nga shteti para se të vuaj dënimin e tij me burg.[80] Jankulovskës gjithashtu i është shqiptuar dënim me burg prej katër vitesh në rastin Fortesa-Target së bashku me ish Drejtorin e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), Sasho Mijallkov, të cilit i është shqiptuar dënim me burg prej 12 vitesh, dhe ish Shefi në Ministrinë e Punëve të Brendshme Goran Gruevski, të cilit i është shqiptuar 15 vite burg. Këto aktgjykime nuk janë të plotfuqishme.[81]

Ligji ka mundësuar që të kalojë kohë e konsiderueshme ndërmjet shpalljes të aktgjykimit të plotfuqishëm dhe fillimit të vuajtjes të dënimit me burg. Në këtë periudhë, personat e dënuar kanë mundësi që të largohen.[82] I tillë ishte rasti me ish Kryeministrin Gruevski.

[79] https://www.slobodnaevropa.mk/a/30230291.html
[80] https://telma.com.mk/2020/09/28/јанкуловска-на-пат-кон-затворот-идриз/
[81] https://360stepeni.mk/presuda-za-target-tvrdina-mijalkov-12-godini-zatvor-jankuloska-4-grujevski-i-boshkovski-po-15-godini/
[82] https://www.osce.org/files/f/documents/1/3/422579.pdf

LIGJET E HARTUARA SIPAS NEVOJËS

Ligjet e hartuara sipas nevojës rrjedhin nga ndikimi i panevojshëm në hartimin e ligjeve. Shfrytëzuesit e ligjeve të hartuara sipas nevojës janë personat fizik, personat juridik apo një grup apo rrjet i ngushtë i personave të lidhur, interesat privat të të cilëve janë të privilegjuara dhe të mbrojtura me legjislacion, në kurriz të interesit publik.

Praktikat e hartimit të ligjeve sipas nevojës për interesat private janë vendosur mirë në Maqedoninë e Veriut. Hulumtimi jonë ka identifikuar tre qëllime kryesore të ligjeve të hartuara sipas nevojës: për të kontrolluar një industri apo sektor, për të arritur pandëshkueshmërinë për korrupsion, dhe për të shmangur mekanizmat e kontrollit.

- Qëllimi më i shpeshtë i ligjeve të hartuara sipas nevojës në Maqedoninë e Veriut është që kontrollohet një industri apo sektor. Kjo mund të marrë formën e rregullimit të subvencioneve, manipulimit të shkallëve doganore për produktet e caktura, uljen e çmimit të tokës shtetërore për projektet e caktuara, etj. Një shembull është liberalizimi i vonuar i qeverisë të Maqedonisë për tregun e telekomunikimit që nga viti 2005. Qeveria ka kërkuar nga operatorët e rinj në treg që të përdorin rrjetin ekzistues të vendosur nga Mobimak. Në vend se të negociojë që të ofrojë shërbime më të lira mobile për qytetarët, qeveria ka nënshkruar një protokoll për të siguar një pozitë të privilegjuar për Mobimak. Në këmbin, aksionari i shumicës i Telekomit maqedonas (Magjar Telekom 53%) ka bërë pagesa të dividendave me vlerë reth 90 milion Euro për qeverinë si aksionar i pakicës (47%). Rasti gjyqësorë Magjar Telekom ka zbuluar një vlerë shumë të madhe të korrupsionit të paguar për politikanët për miratimin e legjislacionit në favor të Mobimak.

- Ligjet e hartuara sipas nevojës janë përdorur gjithashtu për të siguruar pandëshkueshmë për korrupsion. Një amendament i vitit 2018 i Kodit Penal, i diskutuar më detajisht më poshtë, ka zvogëluar sanksionet për keqpërdorimin e procedurës të thirrjes publike (tenderit) dhe një shpërblim të një kontrate të prokurimit publik apo partneritetit publik-privat. Kjo ka rezultuar në pandëshkueshmëri për një person të ndëshkuar për krim.

- Amendamentet ligjore që i mundësojnë qeverisë të vendos dhe të rregullojë çështjet specifike nga aktet nënligjore janë miratuar si mënyrë për të shmangur mekanizmat e kontrollit, si në rastin e Shkupit 2014. Opozita nuk mund të sfidojë një vendim të qeverisë sipas akteve nënligjore ashtu si mund të sfidojë projekt ligjet në Parlament. Vendimet dhe rregullat në fushat e rëndësishme, siç janë tarifat doganore dhe subvencionet industriale, janë lënë në diskrecion të qeverisë. Shpesh ligjet e njëjta janë të hartuara sipas nevojës disa herë. Për shembull, Ligji për ndërtim ka ndryshuar 21 herë në periudhën ndërmjet viteve 2009 dhe 2015 për të mundësuar realizimin e projektit Shkupi 2014. Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore gjithashtu ka patur shumë amendamente në lidhje me ndërtimin e monumenteve për projektin Shkupi 2014.[83]

Ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2018 janë të rëndësisë të veçantë për shkak të ndikimit

[83] Asaf Ademi, Minister i Drejtësisë, deklaratë në konferencë për shtyp në temën "Kapja e shtetit – ilustrim përmes rastit – Ndërtimi i projektit "Shkupi 2014" të mbajtur në 25 qershor të vitit 2018, Shkup.

të tyre në sistemin e drejtësisë në Maqedoninë e Veriut.[84] Ligji për ndryshimin e Kodit Penal 248/2018[85] që është miratuar në 28 dhjetor të vitit 2018, ka ulur dënimin me burg nga pesë në katër vite për rastet që përfshijnë keqpërdorimin e prokurimit publik me dëm apo vlerë të konsideruar.[86] Ndryshimi ka mundësuar që sanksioni të ulet edhe më shumë, deri në dy vjet nëse përmbushen kushtet, që e ka bërë të mundur për gjykatat që të zëvëndësojnë tërësisht dënimin me burg me dënim me kusht (meqënëse gjykatat mund të shqiptojnë dënim me kusht për dënimet me burg deri në dy vjet). Ndryshimet gjithashtu kanë zvogëluar parashkrimin nga 20 në 10 vjet.

Gjashtëmbëdhjetë OJQ i kanë shkruar Parlamentit duke kërkuar që të tërheqin ndryshimet, meqënëse ata mund të sjellin deri te pandëshkueshmëria e të akuzuarve në rastet e PSP-së.[87] Në seancën plenare të Parlamentit, 64 deputetë nga 108 të pranishëm kanë votuar në favor të amendamentit,[88] që ka hyrë në fuqi në 7 janar të vitit 2019. Gjykata e apelit ka zbatuar ndryshimet në rastin TRUST, një rast i korrupsionit të nivelit të lartë me dëme të konsideruara për buxhetin shtetërorë. Gjykata ka zvogëluar dënimet nga gjashtë në katër vite për të akuzuarin e parë, dhe nga tre vjet në dy vjet për të akuzuarin e dytë, që përfundimisht është liruar me dënim me kusht.[89]

LLOJET DHE PROCESI I MIRATIMIT TË LIGJEVE TË HARTUARA SIPAS NEVOJËS

Ligjet e hartuara sipas nevojës zakonisht fshehin dispozitat e dëshiruara në propozimet që janë përgatitur për qëllimet tjera. Zakonisht ndryshimet nuk përputhen me qëllimin e përgjithshëm të ligjit dhe nuk ishin pjesë e debatit publik para parashtrimit të propozimit në Parlament. Megjithatë, ka gjithashtu raste të ligjeve që janë "të hartuara sipas nevojës" në tërësinë e tyre siç është Ligji për Amnesti.[90] Ky ligj ka ndalur të gjithë procedurat penale kundër personave dhe ka liruar nga burgu personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale në 27 prill të vitit 2017, ku 300 persona kanë sulmuar Kuvendin për të penguar një konferencë për shtyp nga kryetari i ri i sapozgjedhur Talat Xhaferi. Pas një debati të gjatë për procesin e pajtimit politik, fraksionet politike miratuan Ligjin për amnesti në dhjetor të vitit 2018. Amnestia nuk është zgjeruar te personat që dyshohet se kanë marrë pjesë në përgatitjen apo organizimin e ngjarjes; personat me identitet të fshehur që kanë përdorur forcë fizike; kryerësit e dhunës; personat jo të autorizuar për mbajtjen e armëve apo materialeve eksploduese; dhe personat që veprojnë duke shkelur autorizimet zyrtare.

Një tjetër ligj i përgatitur sipas nevojës ishte edhe Falja që ka miratuar Presidenti Gjorge Ivanov në 12 prill të vitit 2016 për ish Kryministrin Nikolla Gruevski dhe 54 anëtarë të qeverisë të përfshirë në skandalin e "përgjimeve" dhe shumë raste të PSP-së. Një muaj më vonë, në Maj të vitit 2016 Ivanov ka tërhequr amnestinë. Megjithatë, Gjykata Supreme e Athinës

[84] "Ligji për ndryshimin e Kodit Penal „ ("Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut" Nr. 37/96, dhe Amendamentet: 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7 /2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017, 248/2018).

[85] http://www.slvesnik.com.mk/Issues/b089570baccc436a9b39c585dca78b3f.pdf Neni 275-c. Paragrafi 3 i KP, për veprën penale"Keqpërdorimi i procedurës për thirrjen publike (tenderin), dhurata për kontratën e prokurimit publik apo partneriteti pubik-privat",

[86] Neni 122 i Kodit Penal fq. 35 ofron përkufizim për (35) Përfitimi i konsideruar i pronës, vlerës apo demit nënkupton përfitim, vlerë apo dëm që korrespondon me vlerën prej 50 rrogave mesatare në Republikën e Maqedonisë në kohën e ekzekutimit të "shkallës të lartë"

[87] https://meta.mk/16-graganski-organizatsii-pobara-itno-da-se-povlechat-izmenite-na-krivichniot-zakonik/

[88] https://www.sobranie.mk/sessiondetails.nspx?sessionDetailsId=b60d583c-c0e3-4787-829c-08924da34e11.

[89] https://www.alsat- .tv/mk

[90] Gazeta Zyrare e RM, Nr. 233 nga 20.12.2018

ka cituar aktin e amnestisë dhe faljes nga Presidenti Ivanov[91] si shkaqe për të refuzuar ekstradimin e Nikola Boshkovskit dhe Goran Grujovskit. Dhënia e azilit për Gruevskin në Hungari ishte bazuar gjithashtu në këtë amnesti. Në 29 nëntor të vitit 2019, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut ka miratuar një iniciativë për shqyrtim të Nenit 11-a nga Ligji i faljes, që i ka mundësuar presidentit të tërheq amnestinë e dhënë.[92] Shumica e gjykatësve kanë thënë se Neni 11-a tejkalon kompetenca që i janë dhënë Presidentit në Nenin 84 të Kushtetutës dhe shkel parimin e sundimit të ligjit.[93] TI Maqedoni dhe Sekretariati i Transparency International[94] kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët duke kërkuar dorëheqjen e Presidentit Ivanov.[95] Disa profesorë të fakultetit juridik kanë ndjekur iniciativën e TI duke thënë: "Do të ishte mirë nëse tërheqja e faljeve do të ishte shoqëruar me çfarëdo kualifikimi juridik të faljes si jokushtetuese, respektivisht si një keqpërdorim i qëllimshëm i kompetencave zyrtare të Presidentit. Ndoshta nuk është shumë vonë për Ivanovin që përfundimisht të mbahet përgjegjës për veprimet e tij personale, dhe të iniciohen procedurat penale kundër tij."[96]

Sipas vlerësimit të SNI nga viti 2016, qeveria kontrollon Parlamentin. Qeveria ka propozuar 888 nga 907 ligje të miratuara në periudhën ndërmjet 2011 ose 2014 (98 përqind), përderisa deputetët kanë propozuar vetëm 19 (2 përqind). Ligjet janë miratuar shpesh në bazë të procedurës të shkurtë – aq shpesh sa 70% përqind të kohës në 2016 dhe 2017, sipas Indeksit për Llogaridhënie Transparencë dhe Produktivitet të Kuvendit[97]—që shkurton kohën që deputetët kanë për të shqyrtuar propozim ligjet dhe të përgatisin amendamente.

Zyrtarët mund të kenë konflikt të interesit nëse ata hartojnë politika apo nëse bëjnë negociata në tema në të cilat ata gjithashtu kanë interes privat. Për shembull Komisioni kundër Korrupisonit ka përfunduar se Zëvendës Kryeministri Koço Angjushev kishte konflikt të interesit kur ai mori pjesë në seancë ku qeveria vendosi që të zvogëlojë detyrimet doganore në importimin e baterive elektirke nga litiumi-joni. Angjushev ka fshehur interesin e tij privat si pronar i kompanisë me emër Brako që planifikonte që të importojë këto bateri. Komisioni parashtroi një kërkesë deri te kryeministri për të inicuar procedurat kundër zëvendës kryeministrit.[98] Kryeministri asnjëherë nuk mori ndonjë masë dhe rasti nuk u hetua asnjëherë nga Prokuroria Publike.

SEKTORËT E NDIKUAR NGA LIGJET E HARTUARA SIPAS NEVOJËS

Hulumtimi jonë tregon se ndërtimi është një nga sektorët më të rrezikuar për ligjet e hartuara sipas nevojës. Shumë ligje në lidhje me pronën e tokës dhe ndërtimin janë ndryshuar shpejtë gjatë 15 viteve të fundit.

Për shembull, projekti Shkupi 2014 është prezantuar si një mundësi për ringjallur ekonominë. Me një çmim të vlerësuar prej 680 milion Euro, duhet të ofrojë punë për punëtorët e ndërtimit, aktorët, marangozët, arkitektët, dhe skulptorët. Qeveria dhe kryetari i Komunës Qendër në Shkup kanë kontrolluar shpenzimet dhe ka ndryshuar shumë ligje me dispozita për t'i shërbyer interesit të investitorëve privat.

[91] https://vistinomer.mk/vrhovniot-sud-vo-atina-gi-oslobodil-grujovski-i-boshkovski-vrz-falichen-dokument/

[92] https://sdk.mk/index.php/makedonija/se-aktiviraat-amnestiite-na-ivanov-za-gruevski-jankuloska-mijalkov-janakieski-protoger-pet-ustavni-sudii-ja-stavija-tochkata-na-dneven-red/

[93] Ibid

[94] http://www.transparency.mk/en/index.php?option=com_content&task=view&id=557&Itemid=30

[95] http://www.transparency.mk/en/index.php?option=com_content&task=view&id=557

[96] https://www.slobodenpecat.mk/sudot-vo-strazbur-ke-ja-ozhivuva-aboliczijata-na-ivanov/

[97] Organizata "Most" https://www.pravdiko.mk/se-namaluva-brojot-na-zakoni-doneseni-vo-skratena-postapka/

[98] https://akademik.mk/antikoruptsiskata-komisija-otvori-predmet-za-kocho-angushev/

Sektori i energjisë është gjithashtu i ndikuar nga ligjet e hartuara sipas nevojës. Qeveria ka miratuar dekretet për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e nevojshme dhe kapaciteti i instaluar i përgjithshëm nga prodhuesit e energjisë elektrike. Dekretet mbrojnë dhe garantojnë çmimin e energjisë elektrike të cilin e prodhojnë dhe shesin në tregun e energjisë elektrike. Raportet nga Radio Europa e Lirë kanë zbuluar se një e treta e hidrocentraleve të regjistruara që marrin subvencione janë në pronësi të Zëvendës Kryeministrit Koço Angjushev. Angjushev dhe vëllau i tij kanë themeluar në vitin 2003 kompaninë Feroinvest, që operon me 250 hidrocentrale të vogla, sipas faqes të tij të internetit.[99] Angjushev është tërhequr nga udhëheqësia në vitin 2016 për shkak të pozitës të tij të lartë në qeveri, por si zëvendës kryeministër personalisht merr pjesë në hartimin e ligjeve në sektorin e energjisë. Vëllau i tij ende drejton Feroinvest, që duket se është pronar i pjesërishëm të kompanisë me emër Hidrocentrale të vogla, Shkup, që ka në pronësi shtatë hidrocentraleve shtesë.

Hidrocentralet e vogla janë bërë një çështje e diskutueshme ndërmjet aktiviteteve të mjedisit jetësorë, OJQ-të ekologjike, dhe sektori i energjisë. Grupi i mjedisit jetësorë Eko Vetëdije (Svest) dhe CEE Bankwatch Network kanë dorëzuar ankesë në Komunitetin e energjisë për të shtrirë rregullat e brendshme të BE-së për tregun e energjisë dhe parimet në vendet e Europës Juglindore në një kornizë ligjërisht të detyrueshme. Ankesa pretendon favorizim joproporcional të hidrocentraleve të vogla në Maqedoninë e Veriut mbi burimet tjera energjetike.[100] Maqedonia e Veriut është nënshkruese e Traktatit për Komunitetin Energjetik, që ndalon 'çfarëdo ndihme publke që shtrembëron apo kërcënon që të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar kompanitë e caktuara apo resurset e caktuara të energjisë'. Prodhuesit e formave tjera të energjisë deklarojnë se ata nuk janë në përparësi sepse ata duhet të konkurojnë në tregun e hapur, kurse hidrocentralet e vogla përfitojnë nga çmimi i fiksuar. Përfitimet e hidrocentraleve të vogla janë shumë të larta sipas të dhënave nga regjistri tregtar nga viti 2019, me pesë hidrocentralet më profitabile që realizojnë fitim ndërmjet 100,000 EURO dhe 1 milion EURO.

REAGIMET NDAJ LIGJEVE TË HARTUARA SIPAS NEVOJËS

Duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 2 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të interesit, Komisioni për parandalimin e korrupsionit KSHPK ka pushtetin për të kryer shqyrtim anti-korrupsion të ligjeve, akteve nënligjore, dhe akteve tjera të përgjithshme.[101] KSHPK mund të shqyrtojë dhe të vlerësojë formën dhe përmbajtjen e rregullave që po përgatiten apo tashmë janë miratuar, si dhe të shqyrtojë dhe të parandalojë rrezikun nga korrupsioni i mundshëm dhe konflikti i interesit në ligje, akte nënligjore dhe aktet tjera të përgjithshme. Deklarata e KSHPK duhet të përfshihet në projekt ligjet e prezantuara para deputetëve. Megjithatë, KSHPK nuk ka kapacitet për të realizuar detyrimet e saj sepse ka vetëm një ekzekutiv përgjegjës për kontrollin anti-korrupsion të legjislacionit (KAL). Përveç kësaj, KSHPK ka raportuar se qeveria rrallëherë dërgon rregulla në KSHPK për procedurën KAL. Në raportin e tij vjetor për vitin 2019,[102] KSHPK ka theksuar se qeveria ka dërguar vetëm tre ligje për KAL.

---

[99] http://www.feroinvest.mk/mk/feroinvest-shpp-portfolio/

[100] https://civilmedia.mk/malite-hidrotsentrali-vo-severna-makedonija-se-privilegirani/

[101] Raportet për ligjet e shqyrtuara publikohen në faqen e internetit të KSHPK https://dksk.mk/index.php?id=71

[102] https://dksk.mk/fileadmin/user_upload/2020/Godishen_izveshta___za_rabotata_na_DKSK_-_2019.pdf

LIDHJA ME RASTET KORRUPTUESE

Hulumtimi jonë nuk ka identifikuar raste korruptuese në statistikat gjyqësore që lidhen me ligjet e hartuara sipas nevojës. Megjithatë, rastet korruptuese mund të mos jenë hetuar për shkak të kapjes të shtetit, ndjekjes dhe gjykimit joefektiv, dhe rrjetet e patronazhit të përhapura gjërësisht. Një përjashtim i rrallë është rasti i Maxhar Telekomit që përfshin drejtorët e Maxhar Telekomit. Ata ishin akuzuar për organizatë kriminale, keqpërdorim të pozitës publike, dhe kontraktim të marrëveshjeve të rrejshme të konsulencës, duke dëmtuar buxhetin e Telekomunikimit maqedonas mbi 4 milion Euro dhe buxhetin shtetëror maqedonas mbi 2 milion Euro. Komunikimet me porosi elektronike ndërmjet drejtorëve ekzekutiv të Maxhar Telekomit kanë përmbajtur dëshmi për përgatitje sipas nevojave të Ligjit të vitit 2005 për Marrëdhëniet e punës. Ata u përjashtuan nga dispozitat ligjore për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve kur ata janë transferuar në një punëdhënës të ri si rezultat i ndryshimeve ekonomike dhe strukturore. Pa këtë dispozitë, punëdhënësit nuk kishin obligim që të rikualifikojnë punëtorët e shkarkuar, t'u ofrojnë punësim të ri në kompanitë tjera, apo t'u japin prioritet në punësimet e ardhshme në të njëjtën kompani. Sindikata e punës gjithashtu ishte përjashtuar nga negociatat mbi pakot e shkëputjes.

PËRFUNDIMI

Maqedonia e Veriut ka ratifikuar një numër të madh nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, por vlerësimi jonë tregon zbatim jo të mjaftueshëm të ligjeve të miratuara. Kjo është për shkak të mungesës të kapaciteteve që të miratohen menjëherë mjete dhe metoda të reja të hetimit dhe mungesës të vullnetit politik për t'u ofruar institucioneve resurse të mjaftueshme. Zbatimi i normave ligjore ekzistuese është rrezikuar nga kapja e shtetit nga grupet e interesit dhe rrjetet e patronazhit.

Analiza jonë e rasteve të korrupsionit të lartë tregon dobësitë më të mëdha në sistemin e drejtësisë penale. Sistemi nuk është i duhuri për të zbuluar dhe ndjekur korrupsionin e nivelit të lartë dhe për të parandaluar politizimin dhe kapjen e institucioneve nga interesat e partive në pushtet. Rastet e analizuara janë nga vitit 2005 dhe tregojnë se pandëshkueshmëria nuk është problem i ri por zgjat përmes periudhës të tranzicionit dhe përgjatë qeverive të ndryshme. Dëmi i shkaktuar nga këto vepra penale ka efekt afatgjatë. Megjithatë, zyrtarët e nivelit të lartë kanë mundësinë që të shmangin llogaridhënien përmes shfrytëzimit të rregullave ligjore për shtyrjen e seancave derisa të skadojë parashkrimi.

Shtetet tjera në rajon, duke përfshirë disa shtete anëtare të BE-së, gjithashtu kanë përdorur PSP-në për të ndjekur korrupsionin. Megjithatë, PSP-ja në Maqedoninë e Veriut ka dështuar që të mbajë integritetin dhe profesionalizmin apo të vendos një sistem efikas për ndjekjen e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Ngarkesa e çështjeve të PSP-së dhe prokurorët tashmë janë transferuar në PTHPKOK. Përderisa Këshilli i PP-së duhet të ndihmojë për të siguruar se mbisundon etika profesionale dhe integriteti ndërmjet prokurorëve, besimi i qytetarëve në PP-në është i ulët,[103] dhe ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme për hetimin e korrupsionit të nivelit të lartë. Sistemi juridik duhet të sigurohet se veprat nuk do të vjetërsohen para se të përfundohen hetimet.

Sa i përket gjyqësorit, gjykatësit kanë humbur besimin e qytetarëve pas një numri të madh të dështimeve për të demonstruar pavarësinë e tyre. Kjo ishte pjesërisht për shkak të bisedave të përgjuara në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e gjykatësve në rastet specifike.Për rrjedhojë, ka një kërkesë publike për të përmirësuar vetingun e gjykatësve. Ligjet e reja për Gjykatat, Këshillin Gjyqësorë dhe Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë duhet të ofrojnë kornizën për të përforcuar integritetin dhe llogaridhënien e gjykatësve, por gjithmonë do të lind pyetja për zbatimin e tyre. Përpjekjet e mëparshme, duke përfshirë ndryshimet kushtetuese dhe krijimin e këshillit gjyqësorë të zgjedhur vetëm nga gjykatësit, kanë dështuar që të mbrojnë gjyqësorin nga ndikimi politik.

Faljet e lëshuara nga Presidenti i mëparshëm Ivanov dhe procedurat e ndërlidhura në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut dhe GJEDNJ mund të komplikojnë procedurat gjyqësore vijuese në shumë raste të inicuara nga PSP-ja dhe përpjekjet për të vendosur sundimin e ligjit do të duken të kota. Nevojiten masa efektive për ndryshime sistematike

[103] Sa është besimi në gjyqësor? - EPI, https://epi.org.mk/post/16083

në PP dhe në gjyqësorë. Ndryshimet institucionale mund të nevojiten për të vendosur një qendër të pavarur gjyqësore me autonomi të plotë për të hetuar rastet e korrupsionit të lartë, që do të gjykohen në gjykata të veçanta. Një zgjidhje mund të ishte vendosja e jurisdiksionit ndërkombëtarë për korrupsionin e lartë në çështjet ndër-kufitare.

Ligjet e hartuara sipas nevojës janë relativisht forma të reja të korrupsionit të nivelit të lartë ku legjislacioni dhe rregulloret miratohen apo ndryshohen në qetësi në përfitim të interesit privat të individit apo biznesit. Në Maqedoninë e Veriut, ligjet e hartuara sipas nevojës janë veçanërisht një problem në sektorët e ndërtimit dhe planifikimit urban. KSHPK ka detyrimin ligjor për të kryer shqyrtimin anti-korrupsion të ligjeve por mungon kapaciteti për të realizuar detyrat e tij. Është e nevojshme që të autorizohet përfshirja e ekspertëve anti-korrupsion dhe palëve të përfshira jo vetëm në shqyrtim por edhe në përgatitje dhe negocim të ligjeve.

REKOMANDIMET

1. Këshilli Gjyqësorë dhe Këshilli i Prokurorëve duhet të përmirësojnë zbatimin e masave të integritetit për prokurorët dhe gjykatësit.

2. Komisioni Europian duhet të konsiderojë realizimin e vlerësimeve shtesë të sundimit të ligjit të udhëhequra nga ekspertët, pajtueshmërinë me të drejtën e zbatueshme të BE-së, dhe kapjen e shtetit, ngjajshëm si me *Raportin e Pribesë*.

3. Prokuroria Publik dhe Gjyqësori duhet të zbatojnë strategji të reformave të bazuara në dëshmi, hulumtim dhe praktikën ndërkombëtare; dhe rritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe gjykatësve për të identifikuar dhe proceduar rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, të lirë nga ndikimi politik.

4. Qeveria, akademia dhe shoqëria civile duhet të kryejnë një vlerësim gjithëpërfshirës të shkaqeve themelore të kapjes të shtetit, duke përfshirë dobësitë në gjyqësorë, prokurorinë publike dhe policinë. Vlerësimi duhet të përfshijë monitorimin e pavarur dhe të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme të bazuara në dëshmi.

5. Qeveria duhet të kryejë një analizë të procedurave dhe praktikave që kanë dështuar në parandalimin e kapjes të shtetit në nivel institucional.

6. Qeveria duhet të përfshijë ekspertë kombëtar dhe shoqërinë civile në krijimin e politikave dhe mbikëqyrjen e gjyqësorit, prokurorinë publike dhe policinë, për të siguruar zbatimin e duhur dhe të qëndrueshëm të zgjidhjeve ligjore dhe politikave publike.

7. Qeveria duhet të largojë ndikimin politik nga emërimet, vlerësimet, promovimet dhe shkarkimet e gjykatësve dhe prokurorëve publik, si dhe anëtarëve të Këshillit Gjyqësorë dhe Këshillit të Prokurorëve Publike, përmes instituimit të procedurave publike dhe të pavarura të vetingut.

8. Kuvendi i Maqedonisë së Veriut duhet të ofrojë kritere të qarta dhe procedura transparente për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësorë që nuk zgjidhen nga rradhët e gjykatësve.

9. Gjykatat duhet të ofrojnë shpjegime të detajuara për vendimet për paraburgim.

10. Qeveria duhet të ofrojë resurse dhe kapacitet për KSHPK për të siguruar se shqyrtimi anti-korrupsion i legjislacionit është kryer para se ligjet të dorëzohen në Parlament.

11. Qeveria duhet të përfshijë ekspertët nacional dhe palët tjera të përfshira në grupet punuese për hartimin e ligjeve dhe amendamenteve ligjore.

12. Qeveria duhet të hartojë ligj të ri për të kërkuar raportimin e kontakteve ndërmjet zyrtarëve dhe lobistëve dhe të bëjë të qartë interesin e tyre në aktivitetet legjislative.

13. Qeveria duhet të zbatojë Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të edukojë publikun për raportimin në mbrojtjen e interesit publik.

14. Qeveria duhet të përforcojë kapacitetin e gjyqësorit, PP-së, dhe policisë për të luftuar korrupsionin dhe larjen e parave.

15. Ministria e Drejtësisë duhet të prezantojë kontrollin e detyrueshëm dhë në kohë të sistemit ACCMIS (SIAMLGJ) nga të gjithë trupat e autorizuar.

16. PP-ja duhet të vlerësohet në punën proaktive për të inicuar procedurat kundër korrupsionit me iniciativë të saj.

17. Parlamenti duhet të afirmojë mbikëqyrjen funksionale të prokurorit publik mbi policinë e përfshirë në procedurat penale për të zvogëluar në mënyrë të konsideruar rrezikun e ndërhyrjes nga pushteti ekzekutiv.

18. Qeveria duhet të zgjasë parashkrimin për rastet e korrupsionit të lartë për të parandaluar pandëshkueshmërinë e zyrtarëve të nivelit të lartë.

19. PP-ja duhet të ketë në dispozicion më shumë informacion për punën e saj për publikun, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

343.352:347.96/.99(497.7)(047)

TASEVA, Slagjana
Korrupsioni i lartë dhe hartimi i ligjeve sipas nevojës në Republikën e Maqedonisë së Veriut / [Slagjana Taseva]. - Skopje : Transparency International - Macedonia, 2021. - 38 стр. : илустр. ; 21x28 см

Податокот за авторот преземен од колофон. - Фусноти кон текстот. - Финансиер: Bashkimi Europian, Ndalimi i pandëshkueshmërisëpër korrupsionin e lartë në Ballkanin perëndimor dhe Turq

ISBN 978-608-66251-6-0

а) а) Висока корупција -- Правосудство -- Македонија -- Извештаи

COBISS.MK-ID 53823493

TRANSPARENCY INTERNATIONAL MACEDONIA

Transparency International Macedonia
Tel./Fax: 02 3 21 70 00
info@transparency.mk
www.transparency.mk
www.facebook.com/TransparencyMK
https://twitter.com/TI_Macedonia